

PRAKTIKA PEDAGOGJIKE

DORACAK PËR STUDENTË



ARSIMI PARASHKOLLOR



**FAKULTETI I EDUKIMIT
UNIVERSITETI PUBLIK
"KADRI ZEKA"**



PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	2
HYRJE NË PRAKTIKËN PEDAGOGJIKE.....	5
ROLI I PRAKTIKËS PEDAGOGJIKE NË PËRGATITJEN E EDUKATORËVE. ASPEKTI TEORIK	7
Roli i mentorimit në praktikën pedagogjike.....	9
PROGRAMI I PRAKTIKËS PEDAGOGJIKE	10
PRAKTIKA PEDAGOGJIKE I	11
Përshkrimi i praktikës pedagogjike Ia dhe Ib	11
Rezultatet e të nxënit.....	11
Organizimi i Praktikes pedagogjike Ia dhe Ib	13
Detyrat e studentëve	14
PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II	18
Përshkrimi i praktikës pedagogjike II	18
Rezultatet e të nxënit.....	18
Organizimi i Praktikes pedagogjike II	20
Detyrat e studentëve	21
PRAKTIKA PEDAGOGJIKE III	23
Përshkrimi i praktikës pedagogjike III	23
Rezultatet e të nxënit.....	23
Organizimi i Praktikës Pedagogjike III	25
Detyrat e studentëve	26
PRAKTIKA PEDAGOGJIKE IV	29
Përshkrimi i praktikës pedagogjike IV	29
Rezultatet e të nxënit.....	29
Organizimi i Praktikës Pedagogjike IV	31
Detyrat e studentëve	32
ROLET DHE PËRGJEGJËSITË	35
Roli dhe përgjegjësitë e studentit.....	35
Roli dhe përgjegjësitë e edukatores mentore	37
Roli dhe përgjegjësitë e profesorit mbikqyrës.....	39
Roli dhe përgjegjësitë e bartësit të lëndës	40
Roli dhe përgjegjësitë e koordinatorit të mësimit praktik.....	41
ETIKA DHE INTEGRITETI PROFESIONAL NË PRAKTIKËN PEDAGOGJIKE.....	43

Parimet etike profesionale.....	43
Kodi i mirësjelljes profesionale	45
MBROJTA DHE MIRËQENIA E FËMIJËVE	47
Udhëzime për studentët rreth raportimit të rasteve të dhunës	48
MENTORIMI. MBIKËQYRJA DHE VLERËSIMI I STUDENTËVE PRAKTIKANTË	49
Çfarë është mentorimi?	49
Mbikëqyrja e studentëve nga profesorët	54
Udhëzime për mbikëqyrje.....	54
Raporti profesional	55
Vëzhgimi i studentit gjatë praktikës pedagogjike në institucion	56
Takimi para vëzhgimit	56
Vëzhgimi.....	56
Analiza	Error! Bookmark not defined.
Takimi pas vëzhgimit.....	57
Shënimet dhe reflektimet nga vëzhgimi	57
VLERËSIMI I STUDENTËVE PËR PRAKTIKËN PEDAGOGJIKE	58
Vetëvlerësimi	59
Vlerësimi kolegu-kolegut	61
Shënimet dhe reflektimet	61
Instrumentet për vlerësimin e studentëve sipas viteve	62
REFLEKTIMI	64
Si mund të angazhohen studentët edukatorë në reflektim?.....	66
Udhëzime të përgjithshme për diskutim reflektiv	66
Udhëzime të përgjithshme për të shkruarit reflektiv	68
Disa detaje praktike rreth shkrimit në ditarin reflektiv:	70
Procesi i reflektimit sipas modelit teorik të Boud	72
Procesi i reflektimit sipas modelit teorik të Schon	73
Procesi i reflektimit sipas modelit teorik të Gibbs	74
Reflektimi sipas modelit teorik “Të mësuarit në bazë të përvojës” nga Kolb.....	77
Procesi i reflektimit sipas modelit teorik të Brookfeld	80
Referencat:.....	82
SHTOJCAT	1
INSTRUMENTI I VLERËSIMIT PËR PRAKTIKËN PEDAGOGJIKE Ia	2

INSTRUMENTI I VLERËSIMIT PËR PRAKTIKËN PEDAGOGJIKE Ib.....	5
INSTRUMENTI I VLERËSIMIT PËR PRAKTIKËN PEDAGOGJIKE II.....	8
INSTRUMENTI I VLERËSIMIT PËR PRAKTIKËN PEDAGOGJIKE III.....	13
INSTRUMENTI I VLERËSIMIT PËR PRAKTIKËN PEDAGOGJIKE IV.....	18

HYRJE NË PRAKTIKËN PEDAGOGJIKE

Praktika pedagogjike si pjesë integrale e programeve të Fakultetit të Edukimit në Universiteti Publik “Kadri Zeka” është një komponentë tejet e rëndësishme. Qëllimi i praktikës pedagogjike është që të gjithë studentët përveç njohurive, të zhvillojnë edhe shkathtësi e vlera dhe të jenë profesionistë reflektiv të cilët mësojnë gjatë gjithë jetës dhe të cilët janë të përgatitur për t’iu përgjigjur ndryshimeve shoqërore si dhe zhvillimit të hovshëm të teknologjisë.

Praktika pedagogjike në programin e *Edukimit në fëmijërinë e hershme* paraqet elementin i cili siguron ndërlidhjen midis teorisë dhe praktikës në situata konkrete të punës edukative në institucionet e edukimit në fëmijërinë e hershme. Qëllimet e praktikës pedagogjike i kontribuojnë realizimit të qëllimeve të programit të edukimit të hershëm në veçanti dhe misionit të Fakultetit të Edukimit në përgjithësi.

Praktika pedagogjike fillon qysh në semestrin e parë të vitit të parë të studimeve përmes vëzhgimit në institucionet e fëmijërisë së hershme dhe reflektimit të udhëzuar dhe përfundon me angazhimin e studentëve për të punuar në mënyrë të pavarur nën mbikëqyrjen e edukatorëve mentor në semestrin e fundit të programit kur ata marrin përsipër të gjitha komponentet e zbatimit të profesionit të edukatorit duke ushtruar të gjitha kompetencat profesionale në mënyrë që të jenë të gatshëm për tregun e punës qysh në fazën hyrëse në profesion.

Praktika pedagogjike mund të bëhet në mënyra të ndryshme, për shembull studentët vëzhgojnë një edukatorë mentor në zbatimin e aktiviteteve edukative, studentët marrin pjesë në aktivitete edukative, kryejnë individualisht aktivitete nën drejtimin e një mentori ose studentët punojnë në mënyrë të pavarur për një periudhë më të gjatë pas përvetësimit të disa shkathtësive kryesore të punës me fëmijë dhe menaxhimit të klasës. Pjesëmarrja në praktikën pedagogjike u ofron studentëve mundësi të shumta për testim aktiv në situata konkrete të të nxënies duke integruar mësimdhënien dhe ekspertizën teorike dhe praktike. Praktika pedagogjike i lejon studentët të bëjnë përvetësimin dhe krijimin e njohurive të reja përmes transformimit të përvojave (Jurišević et al. 2005). Identiteti profesional i edukatorëve zhvillohet dhe formohet në periudhën e formimit fillestar të tyre, veçanërisht gjatë praktikës pedagogjike. Ky proces i zhvillimit profesional në

institucionet e edukimit të hershëm zhvillohet me mbështetjen e mentorëve dhe udhëheqësve të praktikës pedagogjike në fakultet. Gjatë procesit të mentorimit, studentët fitojnë njohuri për metodat efektive të mësimdhënies, strategjitë efektive të komunikimit që do t'i ndihmojnë ata të komunikojnë me akterë të ndryshëm në të ardhmen dhe të zhvillojnë aftësi të tjera organizative vendimtare për rolin e tyre të ardhshëm në sistemi arsimor (Soëell, 2017; Hudson et al., 2013; Richter et al., 2013; Feiman-Nemser, 2003).

Edukatori mentor në institucionet e edukimit të hershëm udhëzon studentët në procesin e zbatimit të njohurive në praktikë dhe është i gatshëm të ndajë përvojën dhe materialet e tij/saj me ta, të jap informatë kthyesë (feedback) të inkurajojë reflektimin, ofrojë mundësi për studim të pavarur dhe më vonë punën me fëmijët, beson në aftësitë e studentëve, i mbështet dhe u mundëson atyre të mësojnë për punën dhe detyrat e edukatorëve dhe gjithashtu jep një shembull të punës së një edukatori entuziast në procesin e edukimit të fëmijëve.

Qëllimi i këtij doracaku është që të komunikojë parimet që drejtojnë zhvillimin e programit, si dhe të përshkruajë të priturat, kërkesat, rregullat dhe procedurat, detyrat dhe përgjegjësitë e secilit akter që kanë të bëjnë me implementimin e praktikës pedagogjike në institucione edukative. Ky doracak është një udhëzues për studentë, edukatorët mentorë, profesorët mbikqyrës, profesorët udhëheqës të praktikës pedagogjike dhe të gjithë ata që marrin pjesë përgatitjen profesionale të studentëve.

ROLI I PRAKTIKËS PEDAGOGJIKE NË PËRGATITJEN E EDUKATORËVE. ASPEKTI TEORIK

Gjatë viteve të fundit, hulumtimet shkencore në fushën e arsimit i kanë dhënë mbështetje të madhe pohimit se praktika pedagogjike është një nga komponentët më të rëndësishëm të përgatitjes së edukatorëve para shërbimit.

Praktika lidhet me aspektet e përgatitjes së edukatorëve që mundësojnë zbatimin në praktikë të teorisë dhe ofron mundësi për përvetësimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve brenda një konteksti autentik duke ndërvepruar me akterët kryesor të një institucioni edukativ/arsimor në suaza reale.

Praktika pedagogjike paraqet një proces ndërveprues ndërmjet studentit, mësimdhënësit në fakultet, edukatorit mentor dhe fëmijëve në një mjedis të caktuar edukativ.

Si e tillë, praktika pedagogjike është përvoja më e rëndësishme në programet e përgatitjes së edukatorëve dhe ka një ndikim kyç në të nxëniet e studentëve. Është koha kur studentëve u jepet mundësia të praktikojnë teknikat e mësimdhënies për t'i përgatitur ata për botën reale të profesionit të edukatorit (Mannathoko, 2013). Sipas Aglazor (2011), përvojat e bazuara në terren si praktika pedagogjike e studentëve në përgatitjen e edukatorëve, sigurojnë të lidhin teorinë dhe praktikën, dhe si e tillë ushtrimi i praktikës pedagogjike është pika kulmore që përcakton cilësinë e arsimit të marrë dhe identitetin profesional të edukatorit aspirant (Aglazor, 2011). Si rezultat, praktika pedagogjike është një pjesë thelbësore e kurrikulës përgatitore për edukatorin e fëmijërisë së hershme dhe siguron përvojën e nevojshme në një mjedis real edukativ dhe në punën e drejtpërdrejtë me fëmijët. Ngidi dhe Sibaya (2003) e përkufizojnë atë si një komponent jetik të përgatitjes dhe trajnimit të edukatorëve pasi u ofron atyre mundësinë për të mësuar nga përvoja në vendin e punës.

Studentët fitojnë njohuri të specializuara nga lëndët e ndryshme nga programi i studimit ndërsa praktika pedagogjike i shton vlerë kësaj njohurie kur studentët ndeshen me një situatë reale në klasë (Perry, 2004).

Praktika pedagogjike ofron një mundësi unike për studentët që të provojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre dhe të përjetojnë ndërveprimet e tyre me fëmijët para ose për të hyrë në profesion. Praktika

pedagogjike përfaqëson gamën e përvojave ndaj të cilave studentët janë të ekspozuar kur punojnë në institucione edukative (Marais & Meier, 2002). Ekziston një bazë teorike për të mbështetur përfitimet e praktikës pedagogjike. Përvoja e bazuar në institucion shoqërohet me të mësuarit eksperimental nga Deëey dhe me të mësuarit vëzhgues në teorinë kognitive sociale të Bandura dhe Vygotsky, e cila përfshin ndërtimin e njohurive të reja përmes ndërveprimit social. Sipas Vygotsky, ndërveprimet e dikujt me mjedisin kontribuojnë në suksesin në të mësuar (Schunk, 2004). Për më tepër, sipas teorisë së Knoëles (1950), të rriturit mësojnë më mirë kur janë në një mjedis joformal dhe të rehatshëm. Knoëles pranoi gjithashtu nevojën për fleksibilitet dhe mjedise që nuk janë kërcënuese për procesin e të mësuarit dhe mbrojtje qëndrimit që të rriturit duhet të mësojnë përmes përvojës, duke u fokusuar në procesin e të mësuarit më shumë sesa në përmbajtjen që mësohet.

Motivimi i studentëve për t'u përfshirë në përvojat e të nxënies që u ofrohen gjatë përgatitjes së tyre para shërbimit, veçanërisht në fushat ku shumë studentë nuk kanë vetëbesim, mund të jetë një sfidë. Aspektet që lidhen me të nxënies përmes përvojës dhe reflektimit janë kyçe për motivimin dhe përfshirjen e studentëve në këtë proces mësimor. Teoria e të mësuarit përmes përvojës e Kolb (1984) është një nga teoritë më të njohura arsimore në arsimin e lartë (Healey & Jenkins, 2000) dhe është pjesë e programeve të përgatitjes së mesimdhënësve të rinj. Ideja qendrore e modelit me katër faza të Kolbit është një përshkrim i lehtë i një cikli mësimor që tregon se si përvoja shndërrohet në koncepte përmes reflektimit dhe më pas përdoret si një kornizë për eksperimentimin aktiv dhe përzgjedhjen e përvojave të reja.

Këto katër faza referohen nga Kolb si: a) përvoja konkrete ose të mësuarit përmes “përvojës”, b) vëzhgimit reflektues ose mësimi përmes “ekzaminimit”, c) konceptualizimit abstrakt ose të mësuarit përmes “shpjegimit”, dhe d) eksperimentim aktiv ose të mësuarit përmes “aplikimit”. Këto lëvizin në një cikël njëra pas tjetrës. Cikli mund të fillojë në çdo kohë, por fazat duhet të kryhen që të gjitha. Si rezultat, cikli i të mësuarit ofron reagime, të cilat shërbejnë si bazë për aktivitet të ri dhe një vlerësim të efekteve të tij (Healey & Jenkins, 2000). Kështu, praktika pedagogjike u mundëson studentëve të kalojnë në formë cikli nga njëra fazë në tjetrën dhe kështu të mësojnë nga kjo përvojë në një kontekst ku ndërveprimi është real, reflektimi është pjesë e pandashme e zhvillimit të të kuptuarit dhe konceptualizimit ndërsa mundësia për të provuar dhe aplikuar atë që ke mësuar është e garantuar.

Roli i mentorimit në praktikën pedagogjike

Në tërë këtë proces, edukatorët mentorë ushtrojnë një rol kyç për të ndihmuar studentët të zhvillojnë praktikën e mësimdhënies dhe ofrojnë aftësitë e nevojshme për kalimin e tyre në mësimdhënie të pavarur (Feiman-Nemser, 2003; Normana dhe Feiman-Nemser, 2005). Gjatë procesit të mentorimit, studentët përfitojnë nga modeli i mësimdhënies së edukatorëve mentorë, duke mësuar të zbatojnë teknikat e duhura mësimore, duke kuptuar teknikat efektive të komunikimit që mundësojnë komunikimin e tyre në të ardhmen me palë të ndryshme të interesuara dhe aftësi të tjera organizative thelbësore për pozicionin e tyre të ardhshëm në sistemin edukativ (Soëll, 2017; Hudson et al., 2013; Richter et al., 2013; Feiman-Nemser, 2003).

Edukatorët me përvojë konsiderohen si aktorë të rëndësishëm në procesin e përgatitjes së edukatorëve fillestarë (Spooner-Lane, 2016; Aspors dhe Fransson, 2015; Hobson et al., 2009, Zachary, 2000). Një mentor konsiderohet një mësimdhënës "i cili është më i ditur mbi praktikën e mësimdhënies dhe nëpërmjet proceseve të qarta mentorimi zhvillon vetë-efikasitetin pedagogjik të i mentoruari drejt praktikave autonome të mësimdhënies" (Hudson, 2004, f. 216).

Gjatë praktikës pedagogjike, mentorët japin informata kthyese (feedback), të cilat kanë treguar se ndikojnë te mësimdhënësit/edukatorët fillestarë për të përmirësuar teknikat e tyre mësimore dhe për të avancuar praktikën e tyre të reflektimit (Ambrosetti, 2010; Allan, 2007; Veenman et al., 1998). Mentorët mbështesin studentët duke i udhëhequr gjatë gjithë procesit të tyre të reflektimit duke u bërë pyetje dhe kërkesa të ndryshme. Në këtë proces mentorët kryejnë aktivitete të caktuara stimuluese për të përmirësuar praktikën reflektuese të studentëve, duke përfshirë diskutime që nxitin mendimin rreth mësimdhënies dhe përvojës së të nxënësit, duke analizuar përgjigjet e tyre të ofruara dhe duke lavdëruar përpjekjet dhe arritjet e tyre (Veenman et al., 1998). Të gjitha këto elemente janë thelbësore për një proces të suksesshëm të mentorimit, veçanërisht sepse të mentoruarit duhet të ndihen të kënaqur gjatë procesit të mentorimit.

Në aspektin teorik, një model mentorimi me pesë faktorë është identifikuar më parë (Hudson, 2005), dhe artikujt që lidhen me secilin faktor janë justifikuar gjithashtu empirikisht. Modeli me pesë faktorë njohu atributet personale, kërkesat e sistemit, njohuritë pedagogjike, modelimin dhe informatën kthyese si aspekte thelbësore të mentorimit (Hudson et al., 2005). Ky model përbën bazën teorike të modelit të mentorimit të studentëve i cili përdoret në këtë doracak. Në mënyrë

që mentorimi të ndikojë në zhvillimin efektiv të edukatorëve të ardhshëm, duhet të shfaqet një raport i fortë mentor- i mentoruar (Hudson, 2007; Hudson et al., 2013; Richter et al., 2013). Në këtë proces, mentorëve u kërkohet të nxisin një mjedis mësimi, duke u treguar atyre rëndësinë e attributeve personale (Hudson et al., 2005; Hudson, 2007; Hudson et al., 2013; Kemmis et al., 2014; Soëll, 2017).

PROGRAMI I PRAKTIKËS PEDAGOGJIKE

Praktika pedagogjike përfshihet përgjatë gjithë viteve së studimit, duke u organizuar në total pesë herë brenda katër viteve të studimit. Më poshtë është paraqitur tabela me të dhënat për praktikën pedagogjike në katër vitet e studimit, ndërsa në vijim janë dhënë detajet për organizimin e praktikës në secilin vit akademik.

Tabela1. Informata për organizimin e praktikës

VITI	LËNDA	DITËT NË PRAKTIKË
Viti i I-rë Semestri i dytë	Praktika pedagogjike I	2 javë në IEFH
Viti i II-të Semestri i katërt	Praktika pedagogjike II	6 javë në IEFH
Viti i III-të Semestri i pestë	Praktika pedagogjike III	6 javë në IEFH
Viti i IV-të Semestri i tetë	Praktika pedagogjike IV	10 javë në IEFH

PRAKTIKA PEDAGOGJIKE I

Përshkrimi i praktikës pedagogjike I

Qëllimi kryesor i praktikës pedagogjike I është të ofrojë një eksperiencë për studentët, duke i bërë ata të familjarizohen me funksionalitetin dhe dinamikën e punës edukative në IEFH. Përqëndrimi i studentëve do të jetë në zhvillimin e shkathtësive të vëzhgimit dhe reflektimit, njohjen me rutinat ditore të IEFH, karakteristikat bazë të punës me fëmijët në grupmoshën 0-6 vjeç (në semestrin e dytë), si dhe natyrën e ndërveprimeve në këtë ambient. Gjithashtu, do të adresohen temat si roli i edukatores në këtë moshë të hershme, strategjitë e përkrahjes së zhvillimit të fëmijëve, dhe të gjitha aspektet e rëndësishme të kujdesit dhe edukimit në këtë fazë të hershme të jetës së fëmijëve. Praktika pedagogjike I, do t'i ndihmojë studentëve në përgatitjen e tyre për të qenë të gatshëm dhe të sigurt në punën e tyre si edukatorë të ardhshëm, duke u vlerësuar dhe mbështetur nga edukatorja mentore në fushën e tyre të punës.

Rezultatet e të nxënit

Kompetencat	Rezultatete e të nxënit
Njohuritë	• Njihet me strukturën organizative dhe rolet e secilit punonjës në IEFH; • Përshkruan mjedisin e jashtëm dhe të brendshëm të kopshtit për nga rregullimi, infrastruktura, funksionaliteti, etj; • Përshkruan ndërveprimin e edukatores me fëmijët dhe shpjegon rolin e saj në raport me organizimin e punës brenda grupit; • Përshkruan ndërveprimin e fëmijëve me njëri-tjetër, me mjedisin dhe aktivitetet përmes lojës; • Përshkruan tranzicionin e fëmijëve përgjatë rutinave ditore; • Krahason praktikat edukative të punës me fëmijë e moshës 0-3 vjeç me ato të moshës 3-6 vjeç; (vlen për Praktikën Pedagogjike Ib) • Reflekton për të nxënit e tij/saj në mënyrë të vazhdueshme në ditarin e reflektiv;

Shkathësitë	• Përdor vëzhgimin dhe mban shënime në mënyrë të vazhdueshme; • Përdor reflektimin me shkrim në ditarin reflektiv mbi procesin e vëzhgimit të bërë; • Shkëmben, diskuton dhe ndanë reflektimin e tij/saj me të tjerët (kolegët, edukatore mentore, mbikqyrësin, bartësin e lëndës) me qëllim të zhvillimit profesional; • Komunikon me respekt me të gjitha palet e përfshira në organizimin dhe realizimin e praktikës pedagogjike;
Vlerat	• Ruan etikën e punës me fëmijë gjatë procesit edukativ; • Respekton etikën profesionale të punës dhe të gjitha rregullat e përcaktuara nga Institucioni i Edukimit në Fëmijërinë e Hershme dhe Fakulteti i Edukimit; • Transmeton qëndrim pozitiv në raport me fëmijët, edukatorët dhe të gjithë pjesëtarët e institucionit parashkollor; • Krijon raport profesional me koleget, me edukatorët, stafin e IEFH, prindërit dhe individë të tjerë; • Çmon vlerën e vetëvlerësimit përmes reflektimit dhe të shkruarit reflektiv; • Angazhohet për zhvillim profesional dhe praktikë reflektuese, si në mënyrë të pavarur ashtu edhe në bashkëpunim me kolegët;

Organizimi i Praktikës pedagogjike I

Organizimi i praktikës pedagogjike I realizohet në semestrin II, të vitit të parë. Praktika pedagogjike I realizohet në semestrin e dytë në kuadër të lëndës: Praktika Pedagogjike I, me nga 10 ditë qëndrimi në institucion të edukimit në fëmijërinë e hershme sipas grupmoshës.

- Pjesa praktike e lëndës organizohet në IEFH. Në semestrin e dytë, studentët do të ndjekin praktikën në IEFH me fëmijët e grupmoshës 0-6 vjeç.
- Studentet do të qëndrojnë në institucione parashkollore për një total prej 10 ditësh, organizuar në 5 javë të ndryshme, ku secila javë përfshin dy ditë të plotë qëndrimi në institucion. Kjo strukturë i lejon studentët të integrojnë teorinë me praktikën, duke u ofruar një perspektivë të plotë mbi funksionimin e një mjedisi edukativ dhe rolin e edukatorëve në të.
- Në këtë proces, studentët do të përqendrohen në vëzhgimin dhe reflektimin e tyre për përvojat gjatë qëndrimit në IEFH. Gjithashtu studentët mund të angazhohen dhe asistojnë në përputhje me kërkesat e edukatores mentore dhe nevojave të fëmijëve në këto grupmosha.
- Koordinator i praktikës i komunikon studentëve listën me emrat e institucioneve të edukimit në fëmijërinë e hershme ku ata mund të kryejnë praktikën pedagogjike. Pastaj, studentët caktohen për institucionin dhe edukatoren mentore, ku ata do të ndjekin praktikën.
- Studentët i dërgojnë të dhënat e tyre tek koordinatori i praktikës pedagogjike, i cili përpilon listat e studentëve dhe i dërgon ato tek drejtorët e institucioneve dhe profesorin bartës i lëndës për të siguruar një koordinim të qëndrueshëm të praktikës.
- Përgjatë ligjëratave në kurset e lartëpërmendura, studentëve u jepen instruksione të detajuara për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre gjatë kësaj periudhe praktike. Studentët duhet t'i kenë parasysh përshkrimet e detyrave dhe përgjegjësi si dhe përmbushjen e tyre.
- Gjatë periudhës së praktikës, studentët do të komunikojnë vazhdimisht me edukatorin mentor si dhe me profesorin bartës (gjatë ligjëratave) për të adresuar çdo sfidë ose pyetje që mund të hasin në rrugën e tyre të praktikës.

- Për të dokumentuar angazhimin e tyre në praktikë dhe zhvillimin e tyre profesional, studentët do të reflektojnë në ditarin e tyre (portfolio) duke përfshirë reflektime relevante të përvojave të tyre sipas instruksioneve të profesorit të lëndës.
- Eduktorët mentor do të japin një vlerësim përshkrues në formularin PPIa dhe PPIb (shih tek shtojca) për studentët e mentoruar. Ky proces i dokumentimit do të ndihmojë studentët të përcjellin progresin e tyre dhe të identifikojnë fushat për përmirësim të mëtejshëm në karrierën e tyre pedagogjike.
- Përgjatë ligjëratave studentët diskutojnë për përvojat e tyre gjatë praktikës duke shkëmbyer reflektimet arritjet dhe sfidat e përballura gjatë kësaj periudhe të rëndësishme të zhvillimit profesional.

Detyrat e studentëve

Përgjatë qëndrimit pesëditësh në institucione të edukimit në fëmijërinë e hershme, studentët do të kenë për detyrë të shkruajnë pesë reflektime bazuar në temat e paraqitura më poshtë. Pyetjet orientuese do t'u shërbejnë si udhëzues për të ndihmuar në realizimin e reflektimeve.

Detyra 1. Vëzhgimi dhe reflektimi me shkrim mbi ndërveprimin e edukatores me fëmijët

Gjatë vrojtimit, duhet pasur parasysh pyetjet në vijim:

- Si komunikon edukatori/ja me fëmijët?
- A reflekton edukatorja një ton të ngrohtë dhe të përqendruar në mësim?
- A inkurajon edukatori/ja pjesëmarrjen e të gjithë fëmijëve?
- A ulet ose ndjek një pozicion të ngjashëm me fëmijët për të krijuar një ndjenjë të barabarësisë?
- Si e organizon edukatori/ja kohën dhe hapësirën për të biseduar me secilin fëmijë?
- A është zëri i tij/saj i këndshëm për fëmijët?
- Si e shpreh edukatori/ja respektin për fëmijët gjatë ndërveprimit?
- A përpiqet të krijojë një marrëdhënie afërsie dhe mirëkuptimi me fëmijët?
- A e mban në prehër edukatori/ja ndonjëherë ndonjë fëmijë (vlen për moshën 0-3 vjeç) ?
- Nëse po, kur dhe pse mund të zgjedhin të mbajnë një fëmijë në prehër?
- Si inkurajon edukatori/ja pjesëmarrjen e të gjithë fëmijëve në aktivitete dhe diskutime?
- Sa lejon fëmijët të jenë të pavarur përgjatë rutinave ditore?

- Krahaso praktikën pedagogjike me grupmoshat 3-6 vjeç me atë në grupmoshën 0-3 vjeç (Vlen për praktikën pedagogjike në semestrin e dytë).

Detyra 2. Vëzhgimi dhe reflektimi i mjedisit fizik dhe atij social

Gjatë vërtetimit, duhet të keni parasysh pyetjet në vijim:

- A ka hapësirë të mjaftueshme për numrin e fëmijëve?
- A është mjedisi motivues, nxitës?
- A ka mjaftueshëm lodra, libra, materiale didaktike?
- A ka fotografi apo gjëra të personalizuar (emrat, fotot, foto familjare) etj.?
- A ka punime të fëmijëve në mure?
- A ka fotografi të tjera interesante për fëmijë?
- A është ambient i sigurtë në aspektin fizik dhe atë social?
- A e ka grupi emrin e vet?
- A ka mjaftueshëm dritë?
- Si janë ngjyrat e mureve dhe mobileve?
- A është temperatura e përshtatshme?
- A janë fëmijët të lirë të lëvizin apo rrinë në shtretër?
- A mund të kenë qasje fëmijët tek lodrat?
- Si ndërveprojnë fëmijët me mjedisin e brendshëm dhe atë të jashtëm?
- Krahaso praktikën pedagogjike me grupmoshat 3-6 vjeç me atë në grupmoshën 0-3 vjeç (Vlen për praktikën pedagogjike në semestrin e dytë).

Detyra 3. Vëzhgimi dhe reflektimi i aktiviteteve/lojërave, rutinës ditore

Gjatë vërtetimit, duhet të keni parasysh pyetjet në vijim:

- A e ka planifikuar edukatorja kohën e lojës (qoftë e strukturuar apo e pastrukturuar)?
- A janë përfshirë të gjithë fëmijët?
- Si po ndërveprojnë fëmijët njëri me tjetrin?
- Si po ndërveprojnë fëmijët me lodrat?
- Si po ndërveprojnë fëmijët me edukatoren?

- A janë të lirë të flasin fëmijët?
- Lojërat a janë të fokusuara vetëm në zhvillimin kognitiv apo edhe në fushat e tjera zhvillimore?
- Si po reagojnë fëmijët gjatë tranzicionit nga një rutine në tjetrën?
- Si zhvillohet loja në natyrë?
- Krahazo praktikën pedagogjike me grupmoshat 3-6 vjeç me atë në grupmoshën 0-3 vjeç (Vlen për praktikën pedagogjike në semestrin e dytë).

Detyra 4. Vëzhgimi dhe reflektimi mbi komunikimin në mes të kolegëve dhe komunikimin me prindër

Gjatë vëzhgimit, duhet të keni parasysh pyetjet në vijim:

- Si është mënyra e komunikimit me prindër?
- Çfarë bisede realizohet në mes të edukatorit/es dhe prindërve kur i sjellin dhe i marrin fëmijët?
- Si sillet edukatori/ja me prindërit?
- A ka ndonjë prind që vjen në klasë?
- Si është komunikimin midis kolegeve?
- A bëjnë planifikime të përbashkëta edukatorët për punën me fëmijët?
- A bëjnë planifikime të përbashkëta edukatorët për materialet, për lojën etj.?
- Krahazo praktikën pedagogjike me grupmoshat 3-6 vjeç me atë në grupmoshën 0-3 vjeç (Vlen për praktikën pedagogjike në semestrin e dytë).

Detyra 5. Reflektim mbi përshtatshmërinë personale me profesionin e zgjedhur

Duhet të keni parasysh pyetjet në vijim:

- Cili është qëndrimi i juaj si student lidhur me profesionin e zgjedhur?
- Cilat aspekte të profesionit ju bëjnë të ndiheni të pasionuar?
- Si mendoni, a përputhen vlerat e juaja me vlerat kryesore të një edukatori/e?
- Cilat aftësi, shkathtësi apo vlera mendoni se janë të rëndësishme për një edukator/e të suksesshëm?

- Si e vlerësoni aftësinë tuaj për të komunikuar me fëmijët dhe prindërit (nëse keni pas rast)?
- A keni pasur përvojë të mëparshme në punë me fëmijë?
- Cilat janë arsyet e juaja të cilat kanë nxit dëshirën tuaj për t'u përqendruar në profesionin e zgjedhur?
- A jeni të gatshëm për të mësuar dhe zhvilluar aftësitë tuaja gjatë rrugës së karrierës suaj si edukator/e?
- A e shihni veten më shumë si një edukator/e për fëmijë në grupmoshën 0-3 vjeç apo 3-6 vjeç? Arsyetoni (vlen për praktikën pedagogjike në semestrin e dytë)
-

Vlerësimi për lëndët: Arsimi Parashkollor me praktikë (Sem I dhe Sem II)

Pjesa praktike (20%)	
•	Vërtetimi i vijueshmërisë në praktikë përmes vlerësimit të edukatores mentore (Shtojca 1 për semestrin e parë; Shtojca 2 për semestrin e dytë)
•	Reflektimin mbi detyrat e dhëna (sipas udhëzimeve të dhëna në doracak)
•	Vetëvlerësimi (Shtojca 1 për semestrin e parë; Shtojca 2 për semestrin e dytë)
Pjesa teorike (80%)	
•	Detyrat e caktuara nga profesori i lëndës (Shembull: kolofiume, provim final, detyra, projekt hulumtues, etj.)

PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II

Përshkrimi i praktikës pedagogjike II

Qëllimi i Praktikës Pedagogjike II është të ofrojë një përvojë të pasur dhe të thellë për studentët në procesin e zhvillimit profesional në fushën e edukimit në fëmijëri të hershme. Kjo praktikë synon të përgatisë studentët për të marrë rol aktiv në përfshirjen e tyre në rutinat ditore të një ambienti parashkollor. Në këtë periudhë, fokusi kryesor do të jetë zhvillimi dhe përforsimi i aftësive të vëzhgimit, të reflektimit dhe inkurajimit gradual të studentëve në angazhimin e tyre në aktivitetet pedagogjike. Studentët do të përfshihen në aktivitete përgatitore dhe punë të drejtpërdrejta me fëmijë, duke asistuar edukatoren në organizimin dhe zbatimin e aktiviteteve mësimore. Për këtë qëllim, studentët planifikojnë dhe zhvillojnë aktivitete dhe lojëra të integruara edukative që promovojnë zhvillimin holistik të fëmijëve. Gjatë praktikës, ata bashkëpunojnë ngushtë me edukatorët mentorë dhe kolegët e tyre për të siguruar një mjedis të përkrahur dhe të mësojnë nga përvojat e tyre duke përdorur një portfolio për të dokumentuar dhe organizuar punën e tyre në mënyrë efektive. Kjo do t'i ndihmojë ata të identifikojnë dhe të analizojnë përvojat e tyre në mënyrë që të zhvillojnë një qasje më të thellë dhe më të qëllimshme ndaj punës së tyre pedagogjike. Përveç kësaj, ata ruajnë etikën profesionale dhe respektojnë parimet e diversitetit dhe gjithëpërfshirjes në çdo aspekt të punës së tyre, duke kontribuar në ndërtimin e një shoqërie të përfshirë dhe të respektuar. Praktika Pedagogjike II synon të përgatisë studentët për të qenë profesionist të suksesshëm dhe të përgatitur për sfidat në fushën e edukimit të fëmijëve në fëmijëri të hershme.

Rezultatet e të nxënit

Kompetencat	Rezultatete e të nxënit
Njohuri	• Shpjegon rolin e tij/saj në përfshirjen aktive gjatë rutinave ditore; • Demonstron njohuri fillestare për planifikimin e aktiviteteve dhe lojërave të integruara edukative në shërbim të zhvillimit holistik të fëmijës; • Shpjegon rrjedhën dhe rëndësinë e rutinave ditore; • Ndërlidhin të dhënat nga observimi me teoritë zhvillimore; • Reflekton në mënyrë të vazhdueshme mbi vëzhgimet e bëra,

	regjistron dhe dokumenton të dhënat;
Shkathësitë	• Asiston në realizimin e aktiviteteve nga edukatori/a; • Zhvillon aktivitete të integruara edukative në shërbim të zhvillimit holistik të fëmijës; • Përgatit materiale didaktike për punën me fëmijë duke shfrytëzuar materiale të ripërdorshme; • Siguron gjithëpërfshirjen e fëmijëve në lojë dhe aktivitete; • Komunikon lirshëm me fëmijët përgjatë rutinave ditore dhe organizimit të aktiviteteve; • Vëzhgon në mënyrë të veçantë një fëmijë përgjatë praktikës duke regjistruar dhe dokumentuar të dhënat; • Tregon aftësi për të vetëvlerësuar me saktësi ngritjen e tij/saj profesionale; • Vlerëson në mënyrë kritike përvojat gjatë praktikës dhe mban shënime reflektive për to; • Reflekton, vlerëson dhe mëson nga përvoja e tij/saj duke bërë lidhje të përshtatshme me qëllimet për përvojat që pasojnë; • Përdor portfolio elektronike ose fizike për të organizuar dhe dokumentuar punën e bërë;
Vlerat	• Ruan etikën e punës me fëmijë gjatë procesit edukativ; • Respekton etikën profesionale të punës dhe të gjitha rregullat e përcaktuara nga Institucioni i Edukimit në Fëmijëri të Hershme dhe Fakulteti i Edukimit; • Krijon raporte profesionale me të gjitha palët e përfshira në procesin e mbajtjes dhe organizimit të mësimin praktik; • Bashkëpunon me edukatoren mentore, koleget dhe të tjerët në zhvillimin dhe organizimin e aktiviteteve; • Reflekton në mënyrë konstruktive mbi informatën kthyesë nga

	edukatori/ja dhe mbikqyrësi; • Angazhohet për zhvillim profesional dhe praktikë reflektuese, si në mënyrë të pavarur ashtu edhe në bashkëpunim me kolegët; • Respekton parimet e diversitetit dhe gjithëpërfshirjes duke kontribuar në ndërtimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse.
--	--

Organizimi i Praktikës pedagogjike II

Organizimi i “Praktikës Pedagogjike II” përfshin disa hapa të rëndësishëm për përgatitjen dhe realizimin e saj.

- Pjesa teorike e lëndës "Praktika Pedagogjike II" zhvillohet në Fakultetin e Edukimit. Gjatë kësaj pjese, studentët marrin njohuri teorike dhe diskutojnë për metodat dhe strategjitë më efektive të mësimdhënies, për fëmijët në fëmijëri të hershme.
- Pjesa praktike e lëndës organizohet në institucionet e edukimit në fëmijëri të hershme. Kjo përfshin një periudhë prej 6 javësh. Këto ditë të praktikës shpërndahen sipas orarit mësimor të përgjithshëm dhe disa ditë studenti qëndron në orar të plotë në IEFH ndërsa ditët e tjera me gjysëm orari.
- Në këtë proces, studentët përveç vëzhgimit dhe reflektimit, do të angazohen, asistojnë dhe marrin përsipër organizimin e aktiviteteve në përputhje me kërkesat dhe detyrat e parashtruara në Praktikën pedagogjike II.
- Koordinator i praktikës u komunikon studentëve listën e IEFH ku ata mund të kryejnë praktikën pedagogjike. Pastaj, studentët caktohen për institucionin dhe edukatoren mentor, të cilin ata do të ndjekin gjatë kësaj periudhe praktike.
- Studentët dërgojnë të dhënat e tyre tek koordinatori i praktikës pedagogjike, i cili përpilon listat e studentëve dhe i dërgon ato tek drejtorët e institucioneve, më pas tek profesorët mbikqyrës dhe profesorët e lëndës, për të siguruar një koordinim të qëndrueshëm të praktikës.
- Dita e parë e praktikës organizohet në kampus, ku studentëve u jepen instruksione të detajuara për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre gjatë kësaj periudhe praktike. Studentët duhet t'i kenë parasysh përshkrimet e detyrave dhe përgjegjësi si dhe përmbushjen e tyre.

- Gjatë periudhës së praktikës, studentët do të komunikojnë vazhdimisht me edukatorin mentor dhe me profesorin mbikëqyrës si dhe me profesorin bartës (përgjatë ligjëratave) për të adresuar çdo sfidë ose pyetje që mund të hasin në rrugën e tyre të praktikës.
- Për të dokumentuar angazhimin e tyre në praktikë dhe zhvillimin e tyre profesional, studentët do të vazhdojnë të reflektojnë në ditarin e tyre (portfolio) duke përfshirë reflektime relevante përvojave të tyre. Ky proces i dokumentimit do të ndihmojë studentët të shohin progresin e tyre dhe të identifikojnë fushat për përmirësim të mëtejshëm në karrierën e tyre pedagogjike.
- Në përfundim të praktikës, organizohet dita përmbyllëse në kampus, ku studentët diskutojnë për përvojat e tyre gjatë praktikës duke shkëmbyer arritjet, reflektimet dhe sfidat e përballura gjatë kësaj periudhe të rëndësishme të zhvillimit profesional.

Detyrat e studentëve

Gjatë realizimit të praktikës pedagogjike II, studentët janë të obliguar të dokumentojnë angazhimin përmes detyrave të detajuara më poshtë të cilat dorëzohen si portfolio fizike apo elektronike (varësisht nga infrastruktura e fakultetit):

Detyra 1. Reflektimi në ditarin e studentit.

Studentët reflektojnë në mënyrë kritike në ditarin e tyre për rrjedhën ditore të punës së tyre në IP për secilën ditë të praktikës pedagogjike. Identifikojnë anët pozitive, tregojnë për sfidat në të cilat kanë kaluar gjatë ditës dhe japin rekomandime për ndryshimet eventuale në të ardhmen për punën e tyre si edukatore. Reflektimet nuk paraqesin një përshkrim narrativ të procesit por një analizë kritike të tij. Studentët mund të përdorin edhe teoritë e reflektimit për të avancuar nivelin e reflektimit të tyre.

Detyra 2. Planifikim javor me aktivitete/lojëra të integruara tematike (punë në çifte)

Studentët do të punojnë në çifte për të diskutuar, shkëmbyer ide dhe për të **hartuar planin javor** të punës bazuar në kurrikulat aktuale.

Detyra 3. Planifikimi i dhjetë (10) aktiviteteve me materiale didaktike për punë me grupe të vogla ose individuale për fëmijët deri në 3 vjeç

Studentët përmes mjeteve dhe materialeve të ripërdorshme do të ndërtojnë materiale didaktike që mund të përdoren për fëmijët deri në 3 vjeç.

Kriteret që duhet të përmbajë materiali didaktik janë: Të jetë i sigurt për përdorim; Të mund të përdoret më shumë se një herë; Të mund të përshkruani si ndikon ndërveprimi me këtë material në të nxënit dhe zhvillimin e fëmijës. Aktivitetet mund të paraqiten përmes një modeli të tillë: Foto e aktivitetit, qëllimi, rezultatet e të nxënit dhe procedura e lojës.

Detyra 4. Vëzhgimi 5 javor i një fëmije edhe dokumentimi i vëzhgimit të bërë.

Studentët do të vëzhgojnë një fëmijë përgjatë rutinave ditore dhe do të përshkruajnë aspektet zhvillimore bazuar në praktikën e lëndës së psikologjisë zhvillimore.

Detyra 5. Përshkrimi i përgatitjes së materialeve didaktike për punën me fëmijë duke shfrytëzuar materiale të ripërdorshme dhe diskutimi i tij në auditor.

Studentët përshkruajnë materilin didaktik duke u bazuar në pyetjet më poshtë:

- Çfarë lloj materialesh të ripërdorshme keni përdorur në përgatitjen e materialeve didaktike?
- Cilat janë kriteret për zgjedhjen e materialeve të ripërdorshme të duhur për fëmijët?
- A kanë qenë të përfshirë fëmijët në procesin e krijimit të materialeve didaktike?
- Për çfarë qëllimesh keni krijuar materialin didaktik?
- Argumento përfitimet e fëmijës nga përdorimi i këtij materiali/loje?

Detyra 6. Libri

Studentët do të zgjedhin një libër për lexim për grup-moshën deri në 3 vjeç. Ata do të jenë përgjegjës për përzgjedhjen e një libri për t'ju lexuar fëmijëve, do ta paraqesin librin, përshkruajnë atë dhe mbështesin me argumente teorike pse është e rëndësishme që fëmijëve t'ju lexohet në baza ditore.

Vlerësimi për lëndën: Praktika pedagogjike II

- **Vlerësimi nga bartësi i lëndës. Detyrat 1 deri 6 në portfolio 60%**

• Vlerësimi nga edukatori mentor (20%) (Shtojca 3)
• Vlerësimi nga profesori mbikqyrës (10%) (Shtojca 3)
• Vetëvlerësimi (10%) (Shtojca 3)

PRAKTIKA PEDAGOGJIKE III

Përshkrimi i praktikës pedagogjike III

Gjatë “Praktikës pedagogjike III” studentët dërgohen në grupet edukative në grupmoshat 3-6 vjeç, kjo për arsye që studentët gjatë studimeve të fitojnë eksperiencë për të punuar në të gjitha grupet edukative sipas të gjitha grupmoshave. Studentët do të qëndrojnë në IEFH për 6 javë rresht, duke asistuar edukatoren në të gjitha aktivitete përgatitore dhe të punës së drejtpërdrejtë me fëmijë. Po ashtu, studentët do të reflektojnë në mënyrë kritike për vëzhgimet e tyre, në ditarin personal të praktikës pedagogjike dhe do të përgatisin porfolion për të dokumentuar angazhimin e tyre në praktikë.

Fokusi gjatë kësaj praktikë do të jetë në zhvillimin e shkathtësive për të planifikuar dhe zbatuar strategji të ndryshme të të nxënit bazuar në potencialet e fëmijëve dhe kurrikulën për fëmijërinë e hershme. Për më tepër studentët do të aftësohen për të menaxhuar grupin duke përdorur forma dhe metoda ndërvepruese të të nxënit përmes lojës dhe në mënyrë të vazhdueshme do të vëzhgojnë dhe dokumentojnë zhvillimin e fëmijëve.

Rezultatet e të nxënit

Kompetencat	Rezultatete e të nxënit
Njohuritë	- Analizon Kurrikulën për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme; - Demonstron njohuri për planifikimin e aktivitete dhe lojërave të integruara edukative në shërbim të zhvillimit holistik të fëmijës; - Analizon dhe vlerëson strategji të ndryshme të të nxënit përmes lojës dhe ndërveprimit; - Reflekton në mënyrë të vazhdueshme mbi vëzhgimet e bëra,

	regjistron dhe dokumenton të dhënat;
Shkathësitë	• Asiston në realizimin e aktiviteteve nga edukatori/a; • Zhvillon aktivitete të integruara edukative në shërbim të zhvillimit holistik të fëmijës; • Planifikon lojëra dhe aktivitete duke siguruar gjithëpërfshirjen e fëmijëve; • Përgatit materiale didaktike për punën me fëmijë duke shfrytëzuar materiale të ripërdorshme; • Ndërvepron lirshëm me fëmijët përgjatë rutinave ditore dhe organizimit të aktiviteteve; • Vëzhgon fëmijët përgjatë rutinave ditore nëpër aktiviteteve të ndryshme duke regjistruar dhe dokumentuar të dhënat; • Organizon grupet në forma të ndryshme të punës dhe menaxhon suksesshem ato; • Reflekton, vlerëson dhe mëson nga përvoja e tij/saj duke bërë lidhje të përshtatshme me qëllimet për përvojat që pasojnë; • Përdor portfolio elektronike ose fizike për të organizuar dhe dokumentuar punën e bërë;
Vlerat	• Ruan etikën e punës me fëmijë gjatë vëzhgimit, regjistrimit dhe dokumentimit; • Kujdeset për mjetet, mjaterialet dhe mjedisin e punës; • Respekton etikën profesionale të punës dhe të gjitha rregullat e përcaktuara nga Institucioni i Edukimit në Fëmijëri të Hershme dhe Fakulteti i Edukimit; • Krijon raporte profesionale me të gjitha palët e përfshira në procesin e mbajtjes dhe organizimit të mësimi praktik; • Bashkëpunon me edukatoren mentore, koleget dhe të tjerët në zhvillimin dhe organizimin e aktiviteteve;

- Reflekton në mënyrë konstruktive mbi informatën kthyesë nga edukatori/ja dhe mbikqyrësi;
- Angazhohet për zhvillim profesional dhe praktikë reflektuese, si në mënyrë të pavarur ashtu edhe në bashkëpunim me kolegët;
- Respekton parimet e diversitetit dhe gjithëpërfshirjes duke kontribuar në ndërtimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse.

Organizimi i Praktikës Pedagogjike III

Organizimi i “Praktikës Pedagogjike III” përfshin disa hapa të rëndësishëm për përgatitjen dhe realizimin e saj.

- Pjesa teorike e lëndës "Praktika Pedagogjike III" zhvillohet në Fakultetin e Edukimit. Gjatë kësaj pjese, studentët marrin njohuri teorike dhe diskutojnë për metodat dhe strategjitë më efektive të punës me fëmijët në fëmijëri të hershme.
- Pjesa praktike e lëndës organizohet në institucione të edukimit në fëmijëri të hershme. Kjo përfshin një periudhë prej 6 javësh. Këto ditë të praktikës shpërndahen sipas orarit mësimor të përgjithshëm dhe disa ditë studenti qëndron në orar të plotë në IEFH ndërsa ditët e tjera me gjysëm orari sipas instruksioneve gjatë kampusit të praktikës.
- Në këtë proces, studentët përveç vëzhgimit dhe reflektimit, do të angazhohen, asistojnë dhe marrin përsipër organizimin e aktiviteteve në përputhje me kërkesat dhe detyrat e parashtruara në Praktikën pedagogjike III.
- Koordinator i praktikës komunikon studentëve listën e IEFH ku ata mund të kryejnë praktikën pedagogjike. Pastaj, studentët caktohen për institucionin dhe edukatoren mentor, të cilin ata do të ndjekin gjatë kësaj periudhe praktike.
- Studentët dërgojnë të dhënat e tyre tek koordinatori i praktikës pedagogjike, i cili përpilon listat e studentëve dhe i dërgon ato tek drejtorët e institucioneve, profesorët mbikqyrës dhe profesorët e lëndës, për të siguruar një koordinim të qëndrueshëm të praktikës.

- Dita e parë e praktikës organizohet në kampus, ku studentëve u jepen instruksione të detajuara për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre gjatë kësaj periudhe praktike. Studentët duhet t'i kenë parasysh përshkrimet e detyrave dhe përgjegjësi si dhe përmbushjen e tyre.
- Gjatë periudhës së praktikës, studentët do të komunikojnë vazhdimisht me edukatorin mentor dhe me profesorin mbikëqyrës si dhe me profesorin bartës (përgjatë ligjëratave) për të adresuar çdo sfidë ose pyetje që mund të hasin në rrugën e tyre të praktikës.
- Për të dokumentuar angazhimin e tyre në praktikë dhe zhvillimin e tyre profesional, studentët do të vazhdojnë të reflektojnë në ditarin e tyre (portfolio) duke përfshirë reflektime relevante përvojave të tyre. Ky proces i dokumentimit do të ndihmojë studentët të shohin progresin e tyre dhe të identifikojnë fushat për përmirësim të mëtejshëm në karrierën e tyre pedagogjike.
- Në përfundim të praktikës, organizohet dita përmbyllës në kampus, ku studentët diskutojnë për përvojat e tyre gjatë praktikës duke shkëmbyer reflektimet arritjet dhe sfidat e përballura gjatë kësaj periudhe të rëndësishme të zhvillimit profesional.

Detyrat e studentëve

Gjatë realizimit të praktikës pedagogjike III, studentët janë të obliguar të dokumentojnë angazhim përmes detyrave të detajuara më poshtë të cilat dorëzohen si portfolio fizike apo elektronike (varësisht nga infrastruktura e fakultetit):

Detyra 1. Reflektimi në ditarin e studentit.

Studentët reflektojnë në mënyrë kritike në ditarin e tyre për rrjedhën ditore të punës së tyre në IEFH për së paku 10 ditë pune. Identifikojnë anët pozitive, tregojnë për sfidat në të cilat kanë kaluar gjatë ditës dhe japin rekomandime për ndryshimet eventuale në të ardhmen për punën e tyre si edukatore. Reflektimet nuk paraqesin një përshkrim narrativ të procesit por një analizë kritike të tij. Studentët mund të përdorin edhe teoritë e reflektimit për të avancuar nivelin e reflektimit të tyre.

Detyra 2. Përshkrimi i ecuresë së planit mujor të punës sipas parimeve të kurrikulës.

Studentët do të punojnë në çifte për të diskutuar, shkëmbyer ide dhe për **të hartuar planin mujor** të punës sipas parimeve të kurrikulës. Gjatë kësaj faze, ata do të ndajnë përvojat dhe njohuritë e tyre.

Detyra 3. Përshkrimi i ecuresë dhe rëndësisë së hartimit të planit javor sipas parimeve të kurrikulës

Studentët do të reflektojnë mbi ecurinë dhe rëndësinë e hartimit të planit javor. Ata do të analizojnë komponentet përbërëse të planit javor, mënyrën e realizimit të tij dhe **do ta hartojnë një plan javor**. Kjo detyrë realizohet individualisht nga secili student.

Detyra 4. Dokumentimi i së paku pesë planifikimeve ditore brenda një jave të caktuar (nga plani javor) sipas parimeve të kurrikulës

Studentët do të hartojnë **pesë planifikime ditore** nga plani javor i punës. Kjo detyrë realizohet individualisht nga secili student.

Detyra 5. Përshkrimi i përgatitjes së materialeve didaktike për punën me fëmijë duke shfrytëzuar materiale të ripërdorshme.

Studentët përshkruajnë materialin didaktik duke u bazuar në pyetjet më poshtë:

- Çfarë lloj materialesh të ripërdorshme keni përdorur në përgatitjen e materialeve didaktike?
- Cilat janë kriteret për zgjedhjen e materialeve të ripërdorshme të duhur për fëmijët?
- A kanë qenë të përfshirë fëmijët në procesin e krijimit të materialeve didaktike?
- Për çfarë qëllimesh keni krijuar materialin didaktik?
- Argumento përfitimet e fëmijës nga përdorimi i këtij materiali/loje?

Detyra 6. Vëzhgimi i një fëmije përmes një instrumenti të vëzhgimit dhe reflektimi kritik për instrumentin e përdorur

Studentët duhet të identifikojnë një instrument vëzhgimi që është i përshtatshëm për kontekstin e tyre dhe për qëllimet e tyre të vëzhgimit. Pas përdorimit të instrumentit vëzhgues, pas një periudhe të caktuar vëzhgimi, studentet duhet të reflektojnë mbi pikat e forta apo të dobëta të instrumentit vëzhgues.

Vlerësimi për lëndën: Praktika pedagogjike III	
• Vlerësimi nga bartësi i lëndës. Detyrat 1 deri 6 në portfolio (60%)	
• Vlerësimi i edukatores mentore (20%) (Shtojca 4)	
• Vlerësimi nga profesori mbikqyrës (10%) Studenti performon para profesorit mbikëqyrës realizimin e një aktiviteti apo rutine tjetër ditore. Profesori mbikëqyrës jep vlerësimin në formulari për praktikën pedagogjike III (Shtojca 4)	
• Vetëvlerësimi (10%) (Shtojca 4)	

PRAKTIKA PEDAGOGJIKE IV

Përshkrimi i praktikës pedagogjike IV

Praktika Pedagogjike IV si fokus kryesor ka zhvillimin e të gjitha kompetencave të nevojshme për edukatorët. Përgjatë kësaj praktike, studentët do të përballen me ndërveprimin me fëmijët, zbatimin e strategjive të planifikimit dhe të nxënës, vëzhgimin dhe regjistrimin e veprimtarive, si dhe me rregullimin e mjedisit të të nxënës. Ata gjithashtu do të praktikojnë komunikimin me kolegët, stafin tjetër të institucionit parashkollor dhe prindërit. Në këtë praktikë, studentët do të zhvillojnë shkathhtësitë e tyre si edukatorë hulumtues dhe reflektivë. Kjo praktikë ofron një mundësi të rëndësishme për studentët për të aplikuar njohuritë e tyre të teorisë në praktikë dhe për të përshtatur metodat e tyre të punës me fëmijë në një mjedis real të mësimi.

Rezultatet e të nxënës

Kompetencat	Rezultatet e të nxënës
Njohuri	• Demonstron njohuri për planifikim të integruar në shërbim të zhvillimit holistik të fëmijës; • Tregon lidhjen e të kuptuarit teorik dhe karakteristikave të vëzhguara, dhe nevojave individuale të fëmijëve; • Vlerëson rëndësinë e angazhim në procesin e zhvillimit të tyre profesional; • Zhvillojnë të shkruarit analitik reflektiv si mjet për reflektim dhe zhvillim profesional;
Shkathhtësitë	• Planifikon dhe zhvillon aktivitete të integruara edukative në shërbim të zhvillimit holistik të fëmijës; • Vëzhgon fëmijët dhe planifikon lojëra dhe aktivitete bazuar në interesat e fëmijëve; • Merr pjesë aktive në takimet individuale ose grupore me prindër; • Merr pjesë aktive në takimet me aktivet profesional në IEFH; • Vlerëson në mënyrë kritike përvojat gjatë praktikës dhe mban shënime reflektive për to; • Planifikon përfshirjen e familjes;

	• Dizajnon një instrument vëzhgimi; • Angazhohet për zhvillim profesional dhe praktikë reflektuese, si në mënyrë të pavarur ashtu edhe në bashkëpunim me kolegët; • Përdor portfolio elektronike ose fizike për të dokumentuar punën e bërë;
Vlerat	• Ruan etikën e punës me fëmijë gjatë vëzhgimit, regjistrimit dhe dokumentimit; • Respekton etikën profesionale të punës dhe të gjitha rregullat e përcaktuara nga Institucioni i Edukimit në Fëmijëri të Hershme dhe Fakulteti i Edukimit; • Krijon raporte profesionale me të gjitha palët e përfshira në procesin e mbajtjes dhe organizimit të mësimit praktik; • Bashkëpunon me edukatoren mentore, koleget dhe të tjerët në zhvillimin dhe organizimin e aktiviteteve; • Tregon pjekuri profesionale gjatë pjesëmarrjes në mbledhjet me prindër; • Reflekton mbi informatat kthyese konstruktive nga edukatorët dhe mbikqyrësi nga fakulteti dhe synon përsosjen e vazhdueshme; • Respekton parimet e diversitetit dhe gjithëpërfshirjes duke kontribuar në ndërtimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse; • Kontribuon në krijimin e klimës positive në institucion parashkollor;

Organizimi i Praktikës Pedagogjike IV

Organizimi i “Praktikës Pedagogjike IV” përfshin disa hapa të rëndësishëm për përgatitjen dhe realizimin e saj.

- Praktika pedagogjike IV organizohet në dy pjesë, pjesa teorike dhe ajo praktike.
- Pjesa teorike e lëndës "Praktika Pedagogjike IV" zhvillohet në Fakultetin e Edukimit. Studentët do t'i ndjekin ligjëratat për të zhvilluar dhe praktikuar kompetencat e parapara në program.
- Pjesa praktike e lëndës organizohet në institucionet e edukimit në fëmijëri të hershme. Kjo përfshin një periudhë prej 10 javësh, të ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë të praktikës, studentët do të ndjekin praktikën 5 javore në IEFH me fëmijët e grupmoshës 0-3 vjeç, ndërsa në pjesën e dytë 5 javore, me fëmijë të grupmoshës 3-6 vjeç.
- Në këtë proces, studentët angazhohen në të gjitha proceset edukative që nga planifikimi deri tek realizimi në praktikë. Synimi është që studentët të ushtrojnë të gjitha kompetencat profesionale në mënyrë të pavarur por në mbikëqyrjen e edukatorit mentor dhe këshillimit nga profesori mbikëqyrës.
- Koordinator i praktikës komunikon studentëve listën e institucioneve të edukimit në fëmijëri të hershme ku ata mund të kryejnë praktikën pedagogjike. Pastaj, studentët caktohen për institucionin dhe edukatoren mentor, të cilin ata do të ndjekin gjatë kësaj periudhe praktike.
- Studentët dërgojnë të dhënat e tyre tek koordinatori i praktikës pedagogjike, i cili përpilon listat e studentëve dhe i dërgon ato tek drejtorët e institucioneve, profesorëve mbikëqyrës dhe profesorëve të lëndës, për të siguruar një koordinim të qëndrueshëm të praktikës.
- Dita e parë e praktikës organizohet në kampus, ku studentëve u jepen instruksione të detajuara për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre gjatë kësaj periudhe praktike. Studentët duhet t'i kenë parasysh përshkrimet e detyrave dhe përgjegjësi si dhe përmbushjen e tyre.
- Gjatë periudhës së praktikës, studentët do të komunikojnë dhe bashkëveprojnë vazhdimisht me edukatorin mentor dhe me profesorin mbikëqyrës si dhe me profesorin bartës (përgjatë ligjëratave) për të adresuar çdo sfidë ose pyetje që mund të hasin në rrugën e tyre të praktikës.

- Për të dokumentuar angazhimin e tyre në praktikë dhe zhvillimin e tyre profesional, studentët do të vazhdojnë të reflektojnë në ditarin e tyre (portfolio) duke përfshirë reflektime relevante përvojave të tyre. Ky proces i dokumentimit do të ndihmojë studentët të shohin progresin e tyre dhe të identifikojnë fushat për përmirësim të mëtejshëm në karrierën e tyre pedagogjike.
- Në përfundim të praktikës, organizohet dita përmbyllës në kampus, ku studentët diskutojnë për përvojat e tyre gjatë praktikës duke shkëmbyer reflektimet, arritjet dhe sfidat e përballura gjatë kësaj periudhe të rëndësishme të zhvillimit profesional.

Detyrat e studentëve

Gjatë realizimit të praktikës pedagogjike IV, studentët janë të obliguar që përveç marrjes për sipër të të gjithë procesit të planifikimit dhe zbatimit të të gjitha rutinave ditore në IP të dokumentojnë këtë angazhim përmes detyrave të detajuara më poshtë të cilat dorëzohen si portfolio fizike ose elektronike (varësisht nga infrastruktura e fakultetit):

Detyra 1. Reflektimi në ditarin e studentit.

Studentët reflektojnë në mënyrë kritike në ditarin e tyre për rrjedhën ditore të punës së tyre në IP në mënyrë të vazhdueshme. Identifikojnë anët pozitive, tregojnë për sfidat në të cilat kanë kaluar gjatë ditës dhe japin rekomandime për ndryshimet eventuale në të ardhmen për punën e tyre si edukatore. Reflektimet nuk paraqesin një përshkrim narrativ të procesit por një analizë kritike të tij. Studentët mund të përdorin edhe teoritë e reflektimit për të avancuar nivelin e reflektimit të tyre.

Detyra 2. Përshkrimi i ecurisë së hartimit të planit vjetor/global të punës sipas parimeve të kurrikulës .

Studentët do të punojnë në grup për të diskutuar, shkëmbyer ide dhe për të **hartuar planin vjetor** të punës sipas parimeve të kurrikulës. Gjatë kësaj faze, ata do të ndajnë përvojat dhe njohuritë e tyre.

Detyra 3. Dokumentimi i planifikimit tematik mujor dhe javor dhe ditor

Studentet ndahen në çifte dhe nën mentorimin e edukatores mentore dhe profesorit mbikëqyrës planifikojnë një temë mujore bazuar në grupmoshën ku kryhet praktika përkatëse. E shkoqisin atë në 4 javë dhe në një ditë të javës.

Detyra 4. Dokumentimi i së paku dhjetë planifikimeve ditore sipas parimeve të kurrikulës

Bazuar në protokolet e MASHTI për planifikimin e aktiviteteve edukative studentët dëshmojnë shkathhtësitë e tyre të planifikimit duke dorëzuar 10 plane ditore për dy javë pune në kopsht. Pesë planifikimet e para duhen të jenë nga pjesa e parë e praktikës dhe pesë nga pjesa e dytë e praktikës.

Detyra 5. Dokumentimi i së paku 3 vëzhgimeve të fëmijëve përmes instrumenteve narrative dhe të strukturuar.

Studentët vëzhgojnë së paku 3 fëmijë gjatë rutinave ditore ose gjatë aktivitetit. Studentët përdorin instrumente të ndryshme të vëzhgimit për të trija rastet e vëzhguara.

Detyra 6. Hartimi i një plani për përfshirjen e familjes në institucione parashkollore

Studentët do të përpilojnë një plan ku parashihet përfshirja aktive e prindërve në procesin edukativ. Kontributi i familjes në realizimin e planifikimit mujor ose javor e ditor mund të jetë drejtëpërdrejtë në kopsht por edhe në ambiente të tjera jashtë tij.

Detyra 7. Përshkrimi i një loje të strukturuar ose të lirë dhe evidentimi i ndikimit të saj në zhvillimin tërësor të fëmijëve.

Studentët do të përshkruajnë një lojë dhe do të tregojnë si ndikon ajo në zhvillimin tërësor të fëmijëve. Cilat janë benefitet e asaj loje. Në këtë përshkrim rekomandohet të ketë fotografi dhe loja të përshkruhet hap pas hapi.

Vlerësimi për lëndën: Praktika pedagogjike IV

- **Vlerësimi nga profesori bartës i lëndës. Detyrat 1 deri 7 në portfolio (50%)**
- **Vlerësimi i edukatores mentore (20%) (Shtojca 5)**
- **Vlerësimi nga profesori mbikqyrës (20%) Studenti performon para profesorit mbikëqyrës procesin edukativ nga takimi i mëngjesit deri në kohen e gjumit të fëmijëve. Profesori mbikëqyrës jep vlerësimin në formulari për vlerësimin e praktikës pedagogjike IV (Shtojca 5)**
- **Vetëvlerësimin (10%) (Shtojca 5)**

ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

Roli dhe përgjegjësitë e studentit

Studentët kanë një rol kryesor gjatë praktikës pedagogjike në institucionet e edukimit të fëmijërisë së hershme, pasi gjatë kësaj periudhe do të plotësojnë ndërlidhjen midis njohurive teorike dhe zbatimit në praktikë. Rëndësia e praktikës pedagogjike për studentët qëndron në fitimin e përvojës praktike nën mbikëqyrjen e edukatorëve me përvojë, duke i lejuar ata të zhvillojnë dhe të përmirësojnë aftësitë e tyre të punës me fëmijë në një mjedis real pune. Duke u angazhuar në mënyrë aktive në planifikimin e aktiviteteve, duke zbatuar strategji të përshtatshme të punës me fëmijë nga ana zhvillimore dhe duke krijuar një mjedis nxitës për të nxënëit e fëmijëve, studentët kontribuojnë në zhvillimin tërësor të fëmijëve. Përgjegjësitë e studentëve përfshijnë aspekte të ndryshme të rritjes së tyre profesionale, duke përfshirë komunikimin efektiv me fëmijët, familjet dhe kolegët, respektimin e standardeve etike dhe atyre profesionale, si dhe reflektimin e vazhdueshëm mbi përvojat e tyre të punës me fëmijët. Ata bashkëpunojnë ngushtë me edukatorët mentorë për të vëzhguar procesin e zhvillimit të fëmijëve, për të përshtatur qasjet efektive të punës me fëmijë dhe për të siguruar mirëqenien e përgjithshme të fëmijëve. Nëpërmjet përkushtimit të tyre për të mësuarit dhe përmirësimin e vazhdueshëm, studentet duhet të përkatiten për t'u bërë profesionistë kompetentë të fëmijërisë së hershme, të gatshëm për të bërë një ndikim pozitiv për arritjen e potencialit maksimal të secilit fëmijë.

Përgjegjësitë e studentëve gjatë praktikës pedagogjike, në institucione e edukimit të fëmijërisë së hershme janë:

- Ndjekin praktikën pedagogjike me rregull sipas orareve dhe afateve të përcaktuara.
- Paraqiten në IEFH 20 minuta para se të fillojë dita ose ndërrimi.
- Kryejnë me rregull të gjitha detyrat e përcaktuara për praktikën përkatëse.
- Demonstrojnë sjellje profesionale gjatë tërë kohës. Kjo përfshinë, por nuk është e kufizuar në:
 - Zhvillimin e marrëdhënieve pozitive, profesionale me edukatorin/en mentor dhe me mbikëqyrësin nga fakulteti;
 - Tregimin e respektit për personelin e insitucionit të edukimit të fëmijërisë së hershme dhe fëmijëve;

- Tregimin e entuziazmit për nxënie dhe të qenit gati për të nxënë nga të gjitha situatat dhe përvojat;
- Përdorimin e udhëzimeve dhe këshillave nga edukatori/ja mentor si edhe nga mbikëqyrësit nga fakulteti për të përmirësuar punën;
- Pranimin e dallimeve individuale, të jetë i lirë nga paragjykimet dhe diskriminimi;
- Respektimin e besueshmërisë së informatës për fëmijët;
- Respektimin e kodit të veshjes dhe rregulloreve të tjera të institucionit.
- Rregullojnë kohën për të biseduar me edukatorin/en e tyre mentor për çdo ditë dhe të planifikojnë së bashku ditën në vijim.
- Në varësi të detyrave të praktikës pedagogjike përkatëse, studentët marrin përgjegjësi për planifikimin e aktiviteteve dhe realizimin e tyre. Mënyra e planifikimit të aktiviteteve ndryshon nga viti në vit por kryesisht studentët duhet të mendojnë:
 - Pse po mbahet ky aktivitet?
 - Çfarë do të përfitojnë fëmijët dhe çfarë do të mësojnë ata?
 - Çfarë materiale apo pajisje apo lodra do të përdoren?
 - Çfarë do të bëjë edukatori/ja?
 - Çfarë do të bëjnë fëmijët?
 - Si do të dijë edukatori/ja se qëllimi i aktivitetit është arritur?

Këto planifikime dakordohen paraprakisht me edukatoren mentore.

- Sigurojnë një mjedis të përshtatshëm, nxitës, mbështetës dhe gjithëpërfshirës për edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve.
- Komunikojnë në mënyrë efektive me fëmijët, familjet dhe kolegët për të mbështetur zhvillimin tërësor të fëmijëve.
- Bashkëpunojnë në mënyrë efektive me edukatoren mentore dhe profesorin mbikëqyrës.
- Angazhohen për rritje dhe zhvillim profesional të vazhdueshëm për të përsosur kompetencat profesionale në edukimin e fëmijëve në moshë të hershme.
- Reflektojnë rregullisht në ditarin reflektiv dhe të shkëmbejnë përvojat e tyre me edukatorët mentorë, mbikëqyrësin, kolegët dhe profesorin e lëndës për të përmirësuar praktikën profesionale.
- Shënimet do të përfshijnë

- **Portofolion e planifikimit të aktiviteteve.** Një portofolio për planet e aktiviteteve dhe çdo material që përdoret për t'i mbajtur ato. Studentët këtu mund të përfshijnë edhe kopjet e punimeve të fëmijëve (si p.sh. tregime të shkruara) të cilat kanë rezultuar nga puna e tyre.
- **Ditarin e studentit edukator.** Një ditar të lidhur të të shkruarit reflektiv duke treguar të menduarit e studentit lidhur me atë që ka mësuar, dhe synimet e tij/saj për të nxënit e ardhshëm. Kjo do të përfshijë diskutimin e të nxënit nga përvojat dhe vëtvlerësimi, dhe temat në të cilat studenti ka punuar për t'u përmirësuar, si dhe përshkrimin e përmirësimeve të arritura.
- **Ditarin e edukatores mentore dhe profesorit mbikëqyrës.** Secili student do të ofrojë një ditar të lidhur në të cilin edukatori/ja mentor dhe mbikëqyrësit nga Fakulteti shkruajnë të dhënat e vërtetimit dhe shënimet.

Roli dhe përgjegjësitë e edukatores mentore

Edukatorët luajnë një rol vendimtar në mentorimin e studentëve gjatë praktikës pedagogjike në institucionet e edukimit të fëmijërisë së hershme. Rëndësia e tyre qëndron në ofrimin e mentorimit, udhëzimit dhe mbështetjes për ndihmuar studentët që njohuritë teorike të fituara përgjatë vitit akademik, të arrijë t'i zbatojë edhe në praktikë. Edukatorët me përvojë sjellin njohuri dhe ekspertizë shumë të rëndësishme në procesin e mbikëqyrjes, duke ndihmuar studentët të zhvillojnë aftësitë dhe vetëbesimin e nevojshëm për të menaxhuar dhe zhvilluar shkathhtësitë e nevojshme në punën me fëmijë. Duke prezantuar praktika efektive të punës me fëmijë, duke ofruar informacione kthyes konstruktive dhe duke lehtësuar diskutimet reflektuese, edukatorët gjatë shërbimit sigurojnë që studentët të marrin një përvojë profesionale gjithëpërfshirëse dhe praktike. Përgjegjësitë e edukatorëve mbikëqyrës përfshijnë aspekte të ndryshme të mbikëqyrjes, duke përfshirë ndihmën në planifikim, demonstrimin e qasjeve të punës me fëmijë, nxitjen e një mjedisi stimulues dhe krijimin e një klimë positive në punën me fëmijët. Edukatorët mbikëqyrës duhet të bashkëpunojnë ngushtë me studentët për të vendosur qëllime, për të monitoruar progresin dhe për të adresuar çdo sfidë që lind gjatë praktikës pedagogjike. Për më tepër, edukatorët mbikëqyrës mbështesin standardet etike dhe profesionale, ndërsa udhëzojnë studentët në ndërveprimet e tyre me fëmijët, familjet dhe kolegët. Mbi të gjitha, përkushtimi i edukatoreve

mbikqyrëse, për të mbështetur rritjen dhe zhvillimin e edukatoreve të ardhshme kontribuon në cilësinë e përgjithshme të edukimit të fëmijërisë së hershme dhe vendos një bazë solide për suksesin e studentëve në karrierën e tyre të ardhshme.

Përgjegjësitë e edukatoreve gjatë periudhës kur studentët janë në praktikën pedagogjike, në institucione e edukimit në fëmijëri të hershme janë:

- Mirëpret studentin praktikantë në institucion.
- Ofron udhëzime dhe mbështetje për studentet gjatë praktikës së tyre pedagogjike.
- Ofron informacione konstruktive për planifikimin e procesit të punës me fëmijë, qasje efektive të punës me fëmijë, si dhe teknikat e menaxhimit të grupit/klasës.
- Prezanton praktika dhe qasje efektive të punës edukative me qëllim që studentët të vëzhgojnë dhe të mësojnë prej tyre.
- Bashkëpunon me studentët për të vendosur synime dhe qëllime për zhvillimin e tyre profesional.
- Krijon mundësi për studentët që të reflektojnë mbi përvojat e tyre të punës me fëmijë dhe të identifikojnë fushat për zhvillim të mëtejshëm profesional.
- Krijon mjedis pozitiv dhe gjithëpërfshirës ku studentet ndihen të mbështetur dhe të vlerësuar.
- Ekspozon studentin me të gjitha procedurat administrative.
- Modelon shkathtësitë, aftësitë dhe vlerat përpara studentit praktikant duke qenë shembull i një profesionisti .
- Tregon/shfaq entuziazmin për profesionin para studentëve praktikantë.
- Ekspozon studentin me punën përkatëse dhe e vëzhgon atë duke mbajtur shënime.
- Jep komente konstruktive dhe feedback me shkrim për performancën e studentit dhe e këshillon/udhëzon atë për veprime të caktuara profesionale dhe i ndihmon të reflektojë.
- Vlerëson studentin praktikantë duke përfshirë: raportin me kolegët e institucionit/organizatës përkatës, komunikimin, seriozitetin në angazhim, nivelin e kompetencës së studentit, respektimin e rregullave të institucionit dhe bashkëpunimin me vet [mentorin](#).
- Bashkëpunon me Fakultetin e Edukimit dhe zhvillohet në aspektin profesional në mënyrë të vazhdueshme.

- Merr pjesë në matjet (grumbullimin e të dhënave) që organizon fakulteti për vlerësimin e cilësisë së kompetencave të studentëve dhe praktikës pedagogjike në përgjithësi.

Roli dhe përgjegjësitë e profesorit mbikëqyrës

Mbikëqyrja nga ana e profesorëve luajnë një rol shumë të rëndësishëm në mentorimin e studentëve gjatë praktikës pedagogjike në institucionet e edukimit në fëmijëri të hershme, duke ofruar udhëzime, mbështetje dhe ekspertizë përderisa studentët janë duke u përgatitur për të qenë edukatore të ardhshme. Rëndësia e tyre qëndron në ofrimin e mentorimit që lidh hendekun midis teorisë akademike dhe aplikimit praktik, duke ndihmuar studentët të zhvillojnë aftësitë dhe kompetencat profesionale. Profesorët mbikëqyrës përdorin përvojën dhe njohuritë e tyre në edukimin e fëmijërisë së hershme për të modeluar praktika efektive për studentët, për të dhënë informata kthyesë lidhur me performancën e studentëve gjatë praktikës dhe për të lehtësuar diskutimet reflektuese, duke siguruar që studentët të marrin përvoja gjithëpërfshirëse dhe praktike. Përgjegjësitë e profesorëve mbikëqyrës përfshijnë një sërë detyrash që synojnë zhvillimin profesional të studentëve. Ata duhet të bashkëpunojnë ngushtë me studentët me qëllim që përvojat e studentëve të jenë sa më të mira, profesorët mbikëqyrës gjithashtu avokojnë për suksesin e studentëve, duke promovuar mirëqenien e tyre, avancimin profesional brenda fushës dhe duke krijuar ura lidhëse bashkëpunimi edhe me edukatorët mentore.

Përgjegjësitë e profesorëve mbikëqyrës gjatë periudhës kur studentët janë në praktikën pedagogjike, në institucione e edukimit në fëmijëri të hershme janë:

- Udhëzojnë dhe mbështesin studentët gjatë gjithë përvojës së tyre të praktikës pedagogjike.
- Udhëzojnë studentët për praktika dhe qasje efektive të punës me fëmijë, në mënyrë që studentët të krijojnë një zhvillim efektiv profesional.
- U ofrojnë studentëve informacione kthyesë lidhur me përvojat që janë duke kaluar gjatë praktikës pedagogjike.
- Bashkëpunojnë ngushtë me studentët për të vendosur synime të qarta për zhvillimin e tyre profesional.
- Nxisin studentët për të reflektuar mbi përvojat e tyre të punës në institucione dhe për të identifikuar aspektet që duhet të zhvillohen.

- Këshillojnë studentët në orientimin e sfidave dhe pengesave të hasura gjatë praktikës së tyre pedagogjike.
- Udhëzojnë studentët për procesin e planifikimit dhe zbatimit të aktiviteteve edukative.
- Vëzhgojnë studentët praktikantë në punën e tyre praktike dhe të japin komente kthyes konstruktive.
- Vlerësojnë performancën e studentëve gjatë praktikës varësisht nga rezultatet e pritura të praktikës përkatëse.
- Bashkëpunojnë me edukatoren mentore në IEFH për të qenë në koherencë njëri me tjetrin sa i përket këshillimit dhe udhëheqjes së studentëve në praktikë.
- Sipas kërkesës së IEFH jep kontribut profesional për zhvillimin e praktikave bashkëkohore të edukimit të hershëm.
- Mbështetë studentët për adresimin e rasteve eventuale të raportuara të cënimit të mirëqenies së fëmijëve në IEFH.

Roli dhe përgjegjësitë e bartësit të lëndës

Roli dhe përgjegjësitë e bartësit të lëndës janë thelbësore për të siguruar një ambient të frytshëm mësimor dhe për të ndihmuar në zhvillimin e kompetencave të studentëve. Bartësit e lëndës mundësojnë që studentët të fillojnë praktikën pedagogjike me të njejtën përgatitje paraprake.

- Hartimin dhe implementimin e syllabusit.
- Njoftimin e studentëve me përmbajtjen e syllabusit, doracakun e praktikës pedagogjike, materialet e nevojshme për realizimin e praktikës pedagogjike.
- Ndërlidhjen e teorisë me praktikën pedagogjike për të siguruar një përvojë të integruar mësimore.
- Krijimin e një mjedisi bashkëpunues duke përfshirë bashkëpunimin me studentët dhe profesorin mbikëqyrës.
- Koordinimin e aktiviteteve gjatë mëimit praktik për të siguruar një përvojë të rregullt dhe të qëndrueshme.
- Inkurajimin e qasjes gjithëpërfshirëse dhe praktikës reflektuese për të zhvilluar një qasje të ndërgjegjshme dhe analitike të studentët.

- Mbajtjen e ligjëratave ose takimeve të rregullta apo online me studentët në bazë të orarit dhe syllabusit të caktuar.
- Organizimin e konsultimeve me studentë për të adresuar çështje individuale ose grupe në mënyrë efektive.
- Dhënien dhe vlerësimin e detyrave të caktuara sipas syllabusit të cilat studentët duhet të dorëzojnë me portfoliot e tyre ose online sipas asaj që janë përcaktuar në syllabus (google classroom, sms, etj.)
- Sigurimin e qasjes së të gjithë studentëve të kenë qasje në platformat online të cilat do t'i përdorin gjatë praktikës pedagogjike.
- Organizimin e simulimeve të aktiviteteve me studentë për të promovuar një implementim sa më të mirë të kurrikulës.
- Sigurimin e rregullt të informatave kthyesë për studentët gjatë praktikës për të adresuar çështjet e tyre dhe për të përmirësuar performancën e tyre.
- Përcjelljen e ecursisë së praktikës pedagogjike dhe adresimin e çdo çështjeje që mund të shfaqet në proces.
- Vlerësimin e studentëve në përputhje me kriteret e përcaktuara në syllabus për të siguruar një vlerësim të drejtë dhe objektiv të tyre.

Roli dhe përgjegjësitë e koordinorit të mësimit praktik

Koordinatori i praktikës pedagogjike në Fakultetin e Edukimit është personi përgjegjës për procesin e organizimit të praktikës pedagogjike në secilin program të përgatitjes së mësimeve dhe edukatorëve. Ai/ajo ka përdorur që të sigurojë mbarëvajtjen e këtij procesi që nga planifikimi deri në zbatim të secilës praktikë pedagogjike. Koordinatori i praktikës pedagogjike është ura lidhëse midis të gjithë akterëve të përfshirë në këtë proces. Secili student gëzon të drejtën për të kryer praktikën pedagogjike në institucion dhe kjo lehtësohet nga zyra e praktikës pedagogjike duke u përpjekur që studentëve t'u ofrohet mbështetje maksimale për mbarëvajtje të këtij procesi.

Përgjegjësitë e koordinorit të praktikës pedagogjike janë:

- Takimi me drejtorë të institucioneve arsimore për njoftim të fillimit të Praktikës Pedagogjike (PP).

- Njoftimi i studentëve praktikant për procesin e Praktikës Pedagogjike.
- Sigurimi i numrit të studentëve praktikant me të drejtë për pjesëmarrje në PP.
- Sistemi i studentëve praktikant në institucione arsimore.
- Caktimi i profesorëve mbikëqyrës nga fakultetit.
- Njoftimi i shkollave për fillim të PP.
- Diskutimi i listave me drejtorët e institucioneve arsimore dhe sistemimi i studentëve të mësimdhënësit/edukatorët mentor.
- Mbajtja e Kampusit Informativ me studentët praktikant, para fillimit të PP.
- Njoftimi i menaxhmentit dhe profesorëve për fillim të PP.
- Përpilimi i evidencave të mbikëqyrjes (për profesorët mbikëqyrës).
- Përpilimi i raportit mujor nga mbikëqyrja e profesorëve.
- Mbajtja e Kampusit Kthyes (opcionale).
- Koordinimin e procesit të sigurimit të cilësisë së praktikës pedagogjike duke mbledhur dhe analizuar të dhënat e nevojshme nga terreni.
- Sigurimi i një lidhje të qëndrueshme në mes të shkollave partnere dhe Fakultetit të Edukimit.

ETIKA DHE INTEGRITETI PROFESIONAL NË PRAKTIKËN PEDAGOGJIKE

Etika profesionale përkufizon vlerat bërthamë në fushën e fëmijërisë së hershme dhe promovon udhëzime mbi veprimet e profesionistëve dhe studentëve edukatorë. Qëllimi i etikës profesionale gjatë realizimit të praktikës pedagogjike ka të bëjë me vendosjen e përgjegjësisë së edukatoreve mentorë, mbikëqyrësve dhe studentëve në raport me përgjegjësinë profesionale ndaj fëmijëve dhe prindërve.

Parimet etike profesionale

Gjatë realizimit të praktikës pedagogjike studentët duhet të kenë në konsideratë aspektin etik. Parimet etike profesionale të cilat duhet respektuar në përpikëri, e që janë të lidhura me përgjegjësitë individuale dhe ndaj të tjerëve, janë të paraqitura më poshtë.

Studenti në raport me fëmijët

- Bashkëvepron me fëmijët dhe respekton dinjitetin dhe të drejtat e të gjithëve pa dallim race, religjioni, ngjyre, gjinie, karakteristike fizike, moshe dhe origjine.
- Respekton dhe kupton potencialin individual të secilit fëmijë.
- Krijon dhe mirëmban ambiente të cilat promovojnë zhvillimin social, kognitiv, emocional dhe fizik të fëmijëve.
- Respekton lidhjen në mes të prindërve dhe fëmijëve të tyre, duke mos ndërhyrë në të.
- Siguron gjithëpërfshirjen, pavarësisht zhvillimit të fëmijës.
- Promovon të drejtën e lojës dhe përfshirjes së të gjithë fëmijëve pa dallim.

Studenti në raport me institucionin e edukimit të fëmijërisë së hershme

- Respekton personelin e institucionit dhe bashkëvepron me ta në mënyrë që të cilësohet si person profesionist.
- Respekton të gjitha rregulloret, procedurat, politikat dhe praktikat e institucionit.
- Nuk i lejohe të prish imazhin e institucionit, me përjashtim në rastet kur nuk respektohen ligjet dhe rregulloret që janë dizajnuar për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve.
- U përmbahet të gjitha marrëveshjeve të negociuara në emër të studentit nga ana e Fakultetit të Edukimit.

Studenti në raport me studentët tjerë edukatorë dhe edukatorët mentorë

- Bashkëvepron me studentët tjerë edukatorë në një mënyrë që respekton dinjitetin dhe të drejtat e të gjithëve pa paragjyime për racën, religjionin, ngjyrën, gjininë, orientimin seksual, karakteristikat fizike, moshën, prejardhjen, ose vendin e origjinës.
- Ndërton marrëdhënie bashkëpunuese të mbështetura në besim, respekt dhe sinqeritet.
- Inkurajon të tjerët të respektojnë etikën profesionale dhe raporton rastet në të cilat është shkelur ky kod.
- Ndanë njohuritë, përvojat dhe burimet me edukatorët mentorë dhe studentët e tjerë mentorë.
- Punon për promovimin e një mjedisi gjithëpërfshirës.
- Diskuton dhe bashkëpunon mbi aktivitetet edukative dhe përcaktimin e tyre edhe me studentët e edukatorë, natyrisht kur të dyja palët janë të pajtimit për një diskutim kolegial.
- Bashkëpunon me kolegët e tjerë studentë në vëzhgim të ndërsjellë dhe ruan me konfidencialitet informatën.

Studenti në raport me Fakultetin e Edukimit

- Respekton të gjithë akterët nga Fakultetit i Edukimit të cilët janë të përfshirë në organizimin e praktikës pedagogjike.
- Njih përgjegjësinë dhe shpreh brengat përmes procedurave të caktuara, drejtuar autoriteteve përkatëse.
- Nuk flet dhe nuk vepron në emër të fakultetit.
- Respekton udhëzimet dhe rregulloret të cilat obligojnë punën e tij praktike dhe profesionale në institucionet e edukimit në fëmijëri të hershme.

Në raport me profesionin dhe zhvillimin profesional

- Vepron në një mënyrë profesionale, duke shquar dhe promovuar nderin dhe dinjitetin e profesionit.
- Mbanë veten të kalitur profesionalisht duke lexuar mbi të rejat e fundit shkencore në mënyrë që të ngrit kualitetin e punës me fëmijët gjatë fëmijërisë së hershme dhe të kuptoj fëmijët dhe familjet.

- Nuk angazhohet në aktivitetet që ndikojnë negativisht në cilësinë e detyrave profesionale të tij/saj.
- Tregon integritet profesional në kryerjen e të gjitha detyrave duke u përmbajtur nga aktivitetet jo etike që përfshijnë kopjimin ose keqpërdorimin e autorësisë.
- Përdor resurset e teknologjisë informative duke i'u përmbajtur rregullave etike.
- Ndërton dhe zhvillon raporte profesionale më të gjithë personat e përfshirë.
- Reflekton mbi punën që po të bëj.
- Bën analiza vetëkritike mbi zhvillimin profesional të mbështetur mbi mësimet praktikë nga fakulteti dhe aspektin e zbatimit në praktikë.
- Vetëdijësohet mbi sfidat profesionale dhe punon që përballimin e këtyre sfidave ta bëj me profesionalizëm.

Kodi i mirësjelljes profesionale

Ky kod për mirësjellje profesionale kërkon standardet e sjelljes profesionale që pritet të zbatohen nga studentët edukatorë.

Në lidhje me fëmijët

- Studenti edukator bashkëvepron me fëmijët dhe respekton dinjitetin, dhe të drejtat e të gjithëve pa dallim race, religjioni, ngjyre, gjinie, karakteristike fizike, moshe dhe origjine.
- Studenti edukator mund të mos e zbulojë informatën për fëmijën në rrjedhë të detyrave profesionale, vetëm nëse kërkohet nga ligji ose në konsultim me drejtorin e institucionit ose mbikëqyrësit e fakultetit në rastet kur ka të bëjë me interesat më të larta të fëmijës.

Në lidhje me autoritetet e institucionit parashkollor

- Studenti edukator respekton autoritetet e institucionit të edukimit në fëmijëri të hershme dhe realizon të gjitha bashkëveprimet në mënyrë që të cilësohet si person profesionist.
- Studenti edukator u përmbahet të gjitha marrëveshjeve të negociuara në emër të studentit nga ana e Fakultetit të Edukimit.
- Studenti edukator nuk e prish besueshmërinë e studentëve tjerë edukatorë, fëmijëve ose prindërve ndaj autoriteteve të institucionit të edukimit në fëmijëri të hershme.

Në lidhje me studentët tjerë edukatorë

- Studenti edukator bashkëvepron me studentët tjerë edukatorë në një mënyrë që respekton dinjitetin dhe të drejtat e të gjithëve pa paragjykime për racën, religjionin, ngjyrën, gjininë, orinetimin seksual, karakteristikat fizike, moshën, prejardhjen, ose vendin e origjinës.
- Studenti edukator diskuton punën dhe zotësinë e studentëve tjerë edukatorë vetëm nëse ka pajtim të dyanshëm për qëllimin e vlerësimit kolegjial dhe të nxënies së përbashkët.

Në lidhje me Fakultetin e Edukimit

- Studenti edukator respekton autoritetin e Fakultetit të Edukimit si dhe edukatorët apo bashkëpunëtorët e fakultetit me të cilët bashkëvepron.
- Studenti edukator e njeh përgjegjësinë për të shprehur brengat përmes procedurave drejt autoriteteve të duhura, që të shprehë dinjitetin dhe nderin e të gjithëve që janë të përfshirë.
- Studenti edukator nuk flet dhe nuk vepron në emër të fakultetit.

Në lidhje me profesionin

- Studenti edukator vepron në një mënyrë, e cila e shquan dhe e promovon nderin dhe dinjitetin e profesionit.
- Studenti edukator nuk angazhohet në aktivitetet që ndikojnë negativisht në cilësinë e detyrave profesionale të tij.

MBROJTA DHE MIRËQENIA E FËMIJËVE

Mbrojtja e fëmijëve është përgjegjësi e pa negociueshme dhe obligim ligjor i gjithësecilit.

Institucionet që punojnë me dhe për fëmijët kanë për detyrë absolute të mbrojnë fëmijët nga abuzimi, keqtrajtimi, dhe shfrytëzimi brenda institucionit. **Kjo detyrë është e domosdoshme dhe e panegociueshme.** Siç përcaktohet nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, të gjithë fëmijët kanë të drejtën të kenë shëndetin, sigurinë, mirëqenien si dhe interesi i tyre më i mirë të jetë konsiderata kryesore. Institucionet e edukimit në fëmijëri të hershme kanë për obligim të promovojnë zhvillimi e fëmijëve në mënyrë që ata të arrijnë potencialin e tyre të plotë; të mbrojnë fëmijët nga çdo formë e keqtrajtimit apo neglizhimit të nevojave të fëmijëve; dhe të marrin masat e nevojshme parandaluese dhe reaguese ndaj çdo shkeljeve të të drejtave dhe lirive të fëmijëve.

Çka është keqtrajtimi i fëmijëve?

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, “abuzimi i fëmijëve” ose “keqtrajtimi” përbën “të gjitha format e abuzimit fizik, abuzimit psikologjik, abuzimit seksual, neglizhimit, duke rezultuar në dëm aktual ose potencial të shëndetit të fëmijës, mbijetesës, zhvillimit ose dinjitetit në kontekstin e një marrëdhënieje të përgjegjësisë, besimit ose fuqisë”

Të kuptuarit për keqtrajtimin e fëmijëve përfshin, por nuk kufizohet vetëm në:

- *Abuzimi fizik*- mund të përfshijë goditjen, shkundjen, hedhjen, djegien, ose shkaktimin e dëmtimeve fizike tek një fëmijë.
- *Abuzimi psikologjik*- mund të përfshijë ndikimin tek fëmijët se ata janë të pavlefshëm dhe të padashur, të pamjaftueshëm ose të vlerësuar vetëm për aq sa plotësojnë nevojat e një personi tjetër. Abuzimi psikologjik mund të përfshijë edhe përqeshjet, etiketimet ofenduese, kërcënimet apo veprimet që fëmijët të ndjehen të frikësuar ose në rrezik.
- *Abuzimi seksual*- përfshin nxitjen ose joshjen e një fëmije për të marrë pjesë në aktivitete seksuale, pavarësisht nëse fëmija është në dijeni të asaj që po ndodh. Aktivitetet mund të përfshijnë kontaktin fizik apo pa kontakt fizik, të tilla si inkurajimin e fëmijëve që të sillen në mënyra seksuale të papërshtatshme.

- *Neglizhimi*- përcaktohet si dështim i vazhdueshëm për të përmbushur nevojat themelore fizike dhe/ose psikologjike të fëmijës, që mund të rezultojë në dëmtim serioz të zhvillimit fizik ose njohës të fëmijës.
- *Diskriminimi, ngacmimi dhe bullizmi* gjithashtu janë veprime abuzive dhe mund të dëmtojnë një fëmijë, fizikisht dhe emocionalisht.

Udhëzime për studentët rreth raportimit të rasteve të dhunës

Të gjithë studentët dhe praktikantët duhet të jenë të vetëdijësohen për atë se çka nënkupton keqtrajtim të fëmijëve dhe të veprojnë sipas standardeve më të larta etike gjatë kohës kur janë në institucion parashkollor apo në kontakt direkt me fëmijë. Ata poashtu duhet të jenë të vëmendshëm ndaj shenjave që mund të sugjerojnë se një fëmijë ka nevojë për ndihmë apo ndaj sjelljeve të personelit të institucionit që konsiston në keqtrajtim të fëmijëve. Vendimi nëse duhet të raportohet mund të jetë një përgjegjësi shumë e vështirë. Të gjitha dëshmitë, dyshimet ose shkeljet e pohuara apo të dyshuara të mbrojtjes së fëmijëve **duhet** të raportohen menjëherë tek profesori mbikqyrës, profesori i lëndës dhe koordinatori i praktikës pedagogjike. Parimi udhëheqës duhet të jetë se siguria e fëmijës është gjithmonë konsiderata më e rëndësishme. Këto raportime do të ruhen në mënyrë të sigurtë dhe konfidenciale me qasje të kufizuar tek profesori i lëndës dhe koordinatori i praktikës.

Kur një shqetësim për mbrojtjen e fëmijës është sjellë në vëmendjen tuaj – **VEPRONI**.

- VEPRONI për shqetësimin tuaj / Nëse keni dyshime, raportoni menjëherë.
- Vendoseni fëmijën në qendër. Mbrojtja e fëmijës është konsiderata parësore.
- Koha llogaritet. Siguroni veprimet efektive në kohë, të duhura dhe konfidenciale lidhur me mbrojtjen e fëmijës.
- Keni parasysh se veprat e natyrës penale të cënimit të mirëqenies së fëmijëve raportohen menjëherë në polici dhe ato mund të rezultojnë me hetim dhe dënime.

Për informata më të detajuara mbi mbrojtjen e fëmijëve, referohuni në Ligjin NR. 06/L-084 PËR MBROJTJEN E FËMIJËS- <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844> dhe Politikës së MASHTI për Mbrojtjen e Fëmijëve në Institucionet e Arsimit Parauniversitar <https://masht.rks-gov.net/politika-per-pmbrojtjen-e-femijeve/>

MENTORIMI. MBIKËQYRJA DHE VLERËSIMI I STUDENTËVE PRAKTIKANTË

Suksesi i zhvillimit profesional para shërbimit tek edukatorët vlerësohet dhe bazohet shumë në marrëdhëniet e zhvilluara midis të gjithë akterëve. Të dhënat nga përvojat e studentëve gjatë praktikës pedagogjike në institucionet arsimore në vend kanë treguar se studentët kanë nevojë për krijimin e një raporti të ngushtë dhe pozitiv me edukatorin mentor dhe mbikëqyrësin nga fakulteti në mënyrë që të zhvillojnë kompetencat e tyre profesionale bazuar në një feedback konstruktiv, këshilla praktike gjatë punës së drejtëpërdrejtë me fëmijët, këshilla profesionale nga ekspertë të fushës dhe vetë-reflektim i orientuar bazuar në pritshmëri të matshme të përcaktuara nga programi i praktikës pedagogjike.

Çfarë është mentorimi?

Përkufizimet klasike e definojnë mentorimin si një “ marrëdhënie udhëzuese profesionale në të cilën një mentor me përvojë i vlerësuar nga shoqëria dhe komuniteti profesional vepron si këshilltar për një punonjës me më pak përvojë dhe e ndihmon këtë "të mentoruar" të zhvillojë punën e tij/saj" (Heikkinen, Jokinen, & Tynjälä, 2012, f. 13). Përveq kësaj, mentorimi tani konsiderohet si një mjet i vlefshëm për lehtësimin të të mësuarit përmes reflektimit mbi përvojën personale, zhvillimit të besimit, aftësive dhe përballjes së problemeve në marrëdhëniet profesionale (Aubrey, 2011).

Qëllimi kryesor i mentorimit në arsim është të mbështesë studentët që të reflektojnë në mënyrë kritike mbi njohuritë, aftësitë dhe prirjet e tyre, t'i motivojnë ata duke treguar besim në aftësitë e tyre, të mbështesin studentët gjatë planifikimit dhe zbatimit të aktiviteteve edukative, të jenë shembull pozitiv nga i cili mund të mësosh dhe zhvillohesh në mënyrë që të rrisin aftësinë e tyre për të kryer punën e tyre në mënyrë efektive dhe për të fituar kënaqësi prej saj.



Fig. 1. Rolet e mentorimit

Mësimdhënsit/ edukatorët mentorë janë bashkëpunëtorë të Fakultetit të Edukimit të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e zhvillimit të kompetencave të studentëve praktikantë. Ata, zakonisht janë edukatorë me përvojë të cilët janë të dalluar për cilësi në punën e tyre edukative. Gjithashtu, ata janë të trajnuar për komponentën e mentorimit të studentëve nga vet Fakulteti i Edukimit.

Gjatë praktikës pedagogjike studentëve u caktohet një edukatorë mentor në institucionin ku kryhet praktika pedagogjike. Roli i mentorimit është i pazëvendësueshëm dhe nuk mund të zëvendësohet me asnjë aktivitet tjetër. Modeli 5 faktorësh i Hudson et al. (2005) mbi të cilin është ndërtuar edhe modeli i mentorimit të studentëve të Fakultetit të Edukimit, parashikon që përmes procesit të mentorimi tek studentët të zhvillohen:

- a) Atributeve personale,
- b) Kërkesat e sistemit,
- c) Njohuritë pedagogjike,
- d) Modelimit dhe
- e) Feedbackut

Më poshtë janë përshkruar secili prej pesë faktorëve relevant të cilët në praktikë janë të ndërlidhur ngusht njëri me tjetrin.

Atributet personale

Duke pasur parasysh rëndësinë e attributeve personale, mentorët demonstrojnë një përkushtim ndaj procesit të këshillimit, të vendosur për të diskutuar në thellësi mundësitë dhe sfidat gjatë praktikës pedagogjike në shkollë ose në institucione të edukimit të hershëm. Si rezultat, atributet personale të mentorit ndikojnë që mësuesit/edukatorët e ardhshëm të përqafojnë një qëndrim pozitiv dhe të zhvillojnë vetëbesimin (Hudson et al., 2013; Hudson, 2007). Disa nga cilësitë që mund të zhvillohen tek studentët praktikantë përmes mentorimit cilësor, janë:

- A) Entuziazmi për profesionin. Mësimdhënësit/ edukatorët mentor luajnë një rol kyç në zhvillimin e entuziazmit për punë dhe profesion, tek studentët praktikantë. Pritet që ata të shfaqin para studentëve këtë entuziazëm sepse në të kundërtën studentët do ta shohin profesionin e tyre të ardhshëm si shumë sfidues.
- B) Ngrohtësia dhe humori. Mësimdhënësit/ edukatorët mentor duhet të krijojnë raporte të ngrohta me studentët praktikantë dhe me kolegët e tyre duke u munduar që të shfaqin një humor të mirë dhe kënaqësi në punën që bëjnë. Ata thërrasin studentët në emrin e tyre, japin komente pozitive, janë të buzëqeshur, japin mundësi për të trajtuar probleme që studentit i interesojnë, etj.
- C) Kredibiliteti. Katër komponentët e kredibilitetit të mësuesit/edukatorit janë: vetëbesimi, kompetenca, dinamizmi ose pasioni dhe afërsia. Ndërsa mendoni për secilin nga këta faktorë, mbani mend se kredibiliteti i mësimdhënësit/edukatorit është në sytë e studentëve. Ndikimi vjen kur studentët i shohin mentorët e tyre kredibili në këto katër fusha. Një mësimdhënëës mentor, duhet të shfaq vetëbesim maksimal në punën që kryen, duhet të ndihet kompetent duke argumentuar çdo veprim dhe vendim që merr me fakte dhe përvojë. Shfaqja e dyshimeve në punën që ndërmerr ndikon negativisht tek studentët praktikantë.
- D) Pritshmëri të larta për sukses. Një edukator mentor është kërkues, të inkurajon por edhe të mbështetë me ide për zhvillim, i ndihmon studentit të tejkalojë sfidat dhe bën vlerësimin e punës së studentëve duke përdorur komente konstruktive.

Kërkesat e sistemit

Një faktor tjetër i rëndësishëm në mentorim është mënyra se si praktika dhe përvoja e mentorimit i ndihmon studentët praktikantë të zhvillojnë të kuptuarit dhe aftësitë e tyre për kërkesat e sistemit.

Mentorëve u kërkohet të ofrojnë drejtim të qartë për mësuesit/edukatorët e ardhshëm kur bëhet fjalë për kërkesat nga sistemi arsimor (Hudson et al., 2013; Hudson, 2007). Si i tillë, për një sistem arsimor që funksionon mirë, edukatorët e ardhshëm duhet të pajisen me dokumente udhëzuese që rregullojnë cilësinë

e praktikës, përkatësisht, ligjet, politikat, kurrikulat kombëtare, kuadrin e zhvillimit profesional, politikat dhe praktikat e shkollës dhe dokumente të tjera të lidhura me sistemin e nivelit përkatës arsimor. Një edukator mentor e ballafaqon studentin praktikantë me të gjitha politikat arsimore për sistemin përkatës dhe kërkon nga studenti të familjarizohet me to përmes modelimit personal. Psh. Plotësimi i ditarëve, protokoleve të ndryshme të vëzhgimit, planifikimit, zëbrthimit të kurrikulës, etj.

Njohuritë pedagogjike

Njohuritë pedagogjike janë një tjetër komponentë e rëndësishme për procesin efektiv të mentorimit. Mësimdhënësit/edukatorët e ardhshëm mund të pasurojnë njohuritë e tyre pedagogjike gjatë praktikës në shkollë ose institucion parashkollor bazuar në përvojën e mentorëve dhe modelimin që ata e bëjnë gjatë punës me fëmijë. Njohuritë pedagogjike ndahen në disa komponente kyçe dhe zhvillimi i tyre është në masë të madhe në dorën e mentorëve dhe profesorëve të programit akademik për përgatitjen e mësimdhënësve/edukatorëve.

Komponenti i parë i rëndësishëm i zhvillimit të njohurive pedagogjike lidhet me zhvillimin e aftësive të planifikimit (Hudson et al., 2013) ose përgatitjes paraprake të mësimdhënies dhe të nxënit. I gjithë procesi duhet të analizohet dhe diskutohet në detaje duke përfshirë metodat pedagogjike për realizimin e rezultateve të të nxënit, strategjitë e punës me fëmijë sipas grup-moshave të ndryshme, stilet e të nxënit dhe nevojat individuale të përshtatjes së aktiviteteve, metodat e vëzhgimit, vlerësimit, bashkëpunimit me familjen, etj.

Komponentë tjetër e rëndësishme e njohurive pedagogjike është edhe zhvillimi i shkathtësisë së menaxhimit të klasës dhe krijimit të një mjedisi motivues për të nxënë.

Modelimi

Modelimi nga edukatori mentor është një koncept i rëndësishëm në fushën e zhvillimit profesional të edukatorëve dhe përfshin disa aspekte të rëndësishme:

- A) **Demonstrimi i aftësive dhe sjelljes profesionale:** Edukatori mentor duhet të jetë një shembull i mirë për edukatorët e rinj në aspektet profesionale të punës së tyre, duke përfshirë angazhimin e tyre, respektimin e rregullave dhe vlerave të institucionit të tyre arsimor.
- B) **Përdorimi i metodave të mësimdhënies:** Edukatori mentor duhet të demonstrojë përdorimin e metodave pedagogjike të avancuara. Kjo përfshin edhe aftësinë për të

përdorur teknologjinë në mënyrë të duhur, si dhe për të krijuar mjedise të të nxënësve inovativ dhe tërheqës.

- C) **Vlerësimi dhe feedback-u:** Një edukator mentor duhet të tregojë aftësinë për të vlerësuar dhe për të ofruar feedback konstruktiv dhe të ndihmueshëm për edukatorët e rinj. Kjo përfshin vërejtjet e rregullta mbi performancën mësimore dhe përparimin e tyre profesional.
- D) **Mentorim dhe mbështetje:** Mësimdhënësi/Edukatori mentor duhet të ofrojë mentorim të përqendruar dhe mbështetje për studentët e rinj. Kjo mund të përfshijë diskutime të rregullta për sfidat dhe zhvillimin e tyre profesional, si dhe ndihmën në planifikimin e aktiviteteve të të nxënësve dhe menaxhimin e klasës.
- E) **Ndërgjegjësimi profesional:** Edukatori mentor duhet të ndihmojë në zhvillimin e ndërgjegjësitimit profesional të studentëve të rinj, duke i inkurajuar ata të marrin pjesë në aktivitete të zhvillimit profesional dhe në vazhdimin e studimeve të tyre për të përmirësuar praktikën e tyre mësimore.

Informata kthyese

Marrja e komenteve nga një mentor është thelbësore për të pasur një përvojë të suksesshme praktike. Studentët praktikantë përgjithësisht mësohen të ndërveprojnë në një dhomë me një mësues/edukator mentor, të angazhohen në të nxënësve profesional përmes lëndëve universitare dhe të marrin informata kthyese nga kolegët, mentorin e tyre dhe profesorin mbikëqyrës i universitetit (Scherff, 2008). Informatat kthyese mund të jenë të kërkuara ose të pakërkuara, të shkruara ose verbale, formale ose joformale.

Informatat kthyese mund të përfshijnë qëllime të individualizuara ose standarde të përbashkëta. Megjithatë, ajo që është e rëndësishme është që informata kthyese të jetë efektive, ajo duhet të adresojë qëllimet, përparimin drejt qëllimeve dhe aktivitetet specifike për të bërë përparim (Hattie & Timperley, 2007). Për të përmirësuar praktikën, informatat kthyese duhet të jenë të fokusuar, të dhëna herë pas herë dhe të lidhura për vendosjen e qëllimeve.

Sipas Hudson, në mënyrë që procesi i mentorimit të jetë efektiv, mentorët duhet të kërkojnë që studentët të përmbushin rezultate specifike, në mënyrë që ata më pas të ofrojnë informata kthyese të fokusuar.

Mbikëqyrja e studentëve nga profesorët

Studentët praktikantë përveq mentorimit nga një edukator me përvojë në institucionin e edukimit të hershëm do të mbikëqyren gjatë praktikës pedagogjike edhe nga një mësimdhënës nga fakulteti, duke krijuar kështu një raport trepalësh të ndërveprimit social në të cilin studenti mbështetet për të zhvilluar të gjitha kompetencat e një edukatori të suksesshëm. Është e vërtetuar se mbikëqyrja efektive ndikon pozitivisht në përgatitjen e studentëve edukator kompetent.

Profesori mbikëqyrës nga fakulteti është një person komunikues, mbështetës, inkurajues dhe që jep informatë kthyesë konstruktive që drejton studentin për të reflektuar dhe për të mësuar gjatë praktikës pedagogjike. Në varësi të vitit të studimit përcaktohet edhe procesi i mbikëqyrjes. Zakonisht një profesor mbikëqyrës viziton studentin së paku tri herë gjatë praktikës pedagogjike dhe gjatë kësaj kohe jep informacion kthyes për të ndihmuar studentin edukator në realizimin sa më të suksesshëm të praktikës pedagogjike.

Udhëzime për mbikëqyrje

- Siguroni analizë të shpeshtë me gojë dhe me shkrim. Komentet dhe informatat kthyesë lidhur me punën e studentëve duhet të shkruhen nga edukatori mentor dhe profesori mbikëqyrës nga fakulteti në ditarin, i cili sigurohet nga studenti. Komentet duhet të përfshijnë edhe lëvdata për punën që është bërë mirë, edhe sugjerime se ku duhet bërë përmirësime.
- Gjatë diskutimit me studentin, ndihmoni studentin për të parë përparësitë dhe sukseset, edhe atëherë kur ka gabime. Udhëzoni studentin që të mësojë nga gabimet.
- Së bashku me studentin, përcaktoni një fokusim dhe qëllim të caktuar për secilin vëzhgim të orës së plotë të mbajtur.
- Udhëzoni studentin për të analizuar punën në mënyrë që të shohë ngritjen dhe sferat që kanë nevojë për zhvillim të mëtejshëm. Pra, udhëzoni studentin që të bëjë vetëvlerësim për të parë se çfarë përmirësimesh janë bërë dhe ku ka nevojë ende për përmirësime.
- Përqendroni vëmendjen në rezultatet e nxënies për secilin semestër dhe i jepni përkrahjen që është e nevojshme për arritjet në secilin nivel. Ky është një program i natyrës zhvillimore, i cili

kërkon nga studentët që ta zgjerojnë të kuptuarit dhe t'i zhvillojnë shkathtësitë e tyre gradualisht gjatë dy viteve.

Raporti profesional

Për të ndërtuar raporte kolegiale e profesionale nevojitet kohë. Mbikëqyrësit dhe edukatorët mentorë inkurajohen që të punojnë si ekip për t'i udhëhequr dhe për t'i mbështetur studentët. Duke e njohur njëri-tjetrin dhe duke i kuptuar qëndrimet e njëri-tjetrit lidhur me punën me fëmijët në fëmijëri të hershme, ata mund t'u ofrojnë studentëve përvoja të nxënies që janë sfiduese dhe mbështetëse.

Karakteristika kryesore e raportit ndërmjet tri palëve duhet të jetë respekti. Secili nga këta tre duhet t'i respektojë dhe t'i çmojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe përvojat e secilit prej tyre. Edhe pse në mes tyre do të ketë dallime, nuk duhet të ketë kritikizëm, padrejtësi apo gjykime të pabaza.

Profesorët bartës të lëndëve të praktikës pedagogjike, profesorët mbikëqyrës, edukatorët mentorë dhe studentët inkurajohen që të krijojnë mundësi për biseda të lira profesionale për t'u njoftuar me mendimet, qëndrimet dhe përvojat e njëri tjetrit, në mënyrë që kështu ta ndërtojnë një bazë mbi të cilën do të mund të ndërtojnë raporte produktive dhe begatuese në atmosferë demokratike e jo autoritative. Mungesa e ndërveprimit midis cilit do akter në këtë cikël të komunikimit e vështirëson mbarëvajtjen dhe ulë cilësinë e praktikës pedagogjike.




Fig.2. Cikli i bashkëpunimit midis studentit, profesorit të lëndës, profesorit mbikëqyrës dhe edukatorit mentor

Vëzhgimi i studentit gjatë praktikës pedagogjike në institucion

Gjatë procesit të mbikëqyrjes dhe mentorimit profesori mbikëqyrës dhe edukatori mentor përgatisin në disa etapa vëzhgimin e studentit praktikant duke udhëhequr një aktivitet apo rutinë tjetër gjatë praktikës pedagogjike.

Ky proces kalon në tri etapa:

1. Takimi para vëzhgimit
2. Vëzhgimi
3. Interpretimi i vëzhgimit
4. Takimi pas vëzhgimit

Takimi para vëzhgimit

Rekomandohet që secili mbikëqyrës ose edukatori mentor para se ta vëzhgojnë studentin duke e udhëhequr një aktivitet edukativ apo ndonjë rutinë tjetër ditore, të bisedojnë me studentin për të përcaktuar qëllimin e vëzhgimit.

Qëllimet e këtij takimi janë:

Studenti duhet t'i sqarojë qëllimet e aktivitetit apo rutinës ditore dhe rezultate e pritura.

Studenti edukator dhe vërtetuesi duhet të pajtohen për fokusin apo qëllimin e vëzhgimit.

Vëzhgimi

Vëzhguesi duhet të ulet në një vend nga ku mund të shohë më së miri dhomën dhe, ndërveprimin. Në të njëjtën kohë vëzhguesi duhet të përpiqet që të mos pengojë. Kjo shpesh do të thotë se ai/ajo duhet të ulet në fund të klasës ose të vendit ku zhvillohet aktiviteti dhe nuk duhet të ndërhyjë në aktivitet.

Vëzhguesi duhet të përdorë instrumente e vëzhgimit/vlerësimit në shtojcë sipas vitit të studimit të studentit (ose të bazohet në to) për aspektet për të cilat janë dakorduar me studentin në takimin para vëzhgimit. Në këtë mënyrë vëzhgimi do të jetë i fokusuar. Nëse vëzhgimi do të jetë për

vlerësim final atëherë vëzhguesi plotëson të gjitha pjesët e instrumentit të vëzhgimit. Vlerësimi final nuk do të bazohet vetëm në një vëzhgim të vetëm.

Interpretimi i vëzhgimit

Pas vëzhgimit, bëhet një analizë e informatave të grumbulluara të cilat pastaj rishikohen në formën finale të instrumentit të vëzhgimit. Ato mund të diskutohen midis mbikëqyrësit dhe edukatorit mentor për të parë koherencën midis dy akterëve. Në pikët ku ka shpërputhje midis dy palëve vëzhgimi ka mundësi që nuk ka qenë objektiv dhe kërkohen nga njëri- tjetri argumente për t'u bindur të dyja palët.

Takimi pas vëzhgimit

Menjëherë pas vëzhgimit, studenti edukator dhe vëzhguesi duhet të takohen për t'i shkëmbyer, analizuar dhe interpretuar informatat e mbledhura. Diskutimi i vëzhgimeve duhet të jetë i sinqertë dhe pa gjykime, ku vëzhguesi duhet ta udhëheqë studentin që ai t'i identifikojë përparësitë e tij dhe fushat në të cilat nevojiten ndryshime. Takimi pas vëzhgimit duhet të përfshijë përcaktimin e qëllimeve për zhvillim të mëtejshëm dhe një plan për arritjen e këtyre qëllimeve.

Vëzhguesi mund t'i bëjë studentit pyetje të tilla si:

Në përgjithësi, çfarë mendoni për udhëheqjen e aktivitetit?

A mendoni se fëmijët kanë arritur atë që keni synuar dhe planifikuar?

A ka ndonjë pjesë për të cilën mendoni se ka shkuar veçanërisht mirë dhe që ju ka pëlqyer më së shumti?

A ka ndonjë pjesë të aktivitetit për të cilën mendoni se mund të përmirësohet? Nëse po, si do ta bënit atë ndryshe herën tjetër?

Shënimet dhe reflektimet nga vëzhgimi

Vëzhguesi duhet t'ia japë studentit një kopje të informatave të mbledhura dhe një përmbledhje me shkrim të bisedës. Përmbledhja duhet të jetë e shkurtër, por duhet të përfshijë përparësitë e identifikuar dhe qëllimet e përcaktuara për zhvillim dhe përmirësim. Studentin duhet inkurajuar që t'i shënojë në ditarin e tij/saj përparësitë të cilat i ka identifikuar vërtetuesi. Studenti po ashtu

duhet të shënojë se si do të punojë drejt qëllimeve që i ka përcaktuar për të përmirësuar praktikën.

Studentët edukator po ashtu duhet t'i shënojë reflektimet e tyre në ditar. Shkrimet e tyre në ditar duhet të përfshijnë të menduarit për aktivitetet e të nxënës apo veprimtarinë e tyre, e jo të jenë vetëm shënime faktike. Shkrimet e tyre në ditar duhet të tregojnë se si e lidhin ata teorinë e mësuar me ndërveprimet e tyre me fëmijë. Ata duhet të theksojnë qartë se si do të vepronin ndryshe herën tjetër, për të qenë më efektivë ose për të përmirësuar në ndonjë mënyrë punën e tyre.

VLERËSIMI I STUDENTËVE PËR PRAKTIKËN PEDAGOGJIKE

Studentët vlerësohen në secilin nivel (semestër) të praktikës pedagogjike. Vlerësimi gjatë praktikës pedagogjike ka në fokus zhvillimin e shkathtësive praktike prandaj do të përdoret:

vlerësimi formativ (gjatë praktikës përmes vëzhgimit dhe informatave kthyese) dhe

vlerësimi përmbledhës (në fund të praktikës përmes instrumentit të standardizuar).

Gjatë vlerësimit të studentëve do të përdoren disa forma të vlerësimeve, varësisht nivelit dhe kriterëve të vlerësimit, si:

Vlerësimi përshkrues dhe përmbledhës nga edukatori mentor;

Vlerësimi përmbledhës nga mbikëqyrësi i praktikës;

Vetë-vlerësimi

Vlerësimi kolegu-kolegut

Në vitin e parë, praktika pedagogjike është pjesë e lëndëve:

Arsimi Parashkollor me praktikë (mosha 0-3 vjec)

Arsimi Parashkollor me praktikë (mosha 3-6 vjec).

Përgjegjësia e vlerësimit në këtë nivel i takon profesorëve bartës të këtyre lëndëve dhe kriteret janë përcaktuar qartë në instrumentet e vlerësimit në shtojcë. Megjithatë, kriter bazë për këtë vlerësim është vërtetimi i vlerësimit përshkrues nga edukatorët mentorë në IEFH gjë që dëshmon pjesëmarrjen në praktikë bazuar në pritshmëritë e kursit.

Në vitin e dytë, Praktika pedagogjike dy do të vlerësohet përmes vëzhgimeve të vazhdueshme dhe informatave kthyese ndërsa për vlerësimin final do të grumbullohen pikët nga:

1. Vlerësimi nga bartësi i lëndës
2. Vlerësimi i edukatorit mentor
3. Vlerësimi i profesorit mbikëqyrës
4. Vetëvlerësimi

Në vitin e tretë, Praktika pedagogjike III do të do të vlerësohet përmes vëzhgimeve të vazhdueshme dhe informatave kthyesë ndërsa për vlerësimin final do të grumbullohen pikët nga:

1. Vlerësimi nga bartësi i lëndës
2. Vlerësimi i edukatorit mentor
3. Vlerësimi i profesorit mbikëqyrës
4. Vetëvlerësimi

Në vitin e katërt, Praktika pedagogjike IV do të vlerësohet përmes vëzhgimeve të vazhdueshme dhe informatave kthyesë ndërsa për vlerësimin final do të grumbullohen pikët nga:

1. Vlerësimi nga profesori bartës i lëndës.
2. Vlerësimi i edukatorit mentor
3. Vlerësimi i profesorit mbikëqyrës
4. Vetëvlerësimi

Vërejtje: Secila praktikë pedagogjike ka të caktuar ngarkesën e detyrave dhe përqindjen e vlerësimit të cilat ndryshojnë nga viti në vit.

Vetëvlerësimi

Vetëvlerësimi i studentëve është një proces ku studentët reflektojnë dhe vlerësojnë performancën e tyre akademike ose përparimin personal në një kurs ose projekt.

Ky proces është i rëndësishëm për disa arsye:

1. *Reflektim mbi mësimin:* Studentët kanë mundësinë të mendojnë për atë që kanë mësuar dhe si e kanë përvetësuar atë.
2. *Rritja e ndërgjegjësimit për aftësitë personale:* Vetëvlerësimi i ndihmon studentët të njohin pikat e forta dhe dobësitë e tyre, duke kontribuar në zhvillimin e aftësive të menaxhimit të vetvetes.

3. *Rritja e përgjegjësisë*: Duke marrë pjesë aktive në procesin e vlerësimit, studentët bëhen më përgjegjës për mësimin dhe përparimin e tyre.

4. *Zhvillimi i aftësive të kritikës konstruktive*: Studentët mësojnë të japin dhe të pranojnë kritika konstruktive, një aftësi e rëndësishme në shumë fusha të jetës.

Procesi i vetëvlerësimit zakonisht përfshin disa hapa:

1. *Vendosja e qëllimeve*: Studentët duhet të kenë të qarta cilat janë qëllimet e tyre dhe çfarë pritet prej tyre në kuadër të praktikës pedagogjike, kursit ose projektit.

2. *Mbledhja e provave*: Studentët mbledhin materiale dhe shembuj të punës së tyre që ilustrojnë përparimin dhe arritjet e tyre.

3. *Analiza dhe reflektimi*: Studentët analizojnë materialet e mbledhura dhe reflektojnë mbi përvojat e tyre mësimore.

4. *Shkrimi i raportit të vetëvlerësimit*: Studentët shkruajnë një raport ku përmbledhin analizat dhe reflektimet e tyre, duke përfshirë arritjet dhe fushat ku kanë nevojë për përmirësim.

5. *Diskutimi me mentorët ose mbikqyrësit*: Në disa raste, rezultatet e vetëvlerësimit diskutohen me mentorët ose mbikqyrësit për të marrë feedback dhe për të planifikuar hapat e ardhshëm.

Vetëvlerësimi është një mjet i fuqishëm për të rritur angazhimin dhe përgjegjësinë e studentëve në procesin e mësimdhënies dhe mësimin. Ai kontribuon në zhvillimin e aftësive të rëndësishme të jetës, si aftësia për të menduar në mënyrë kritike, reflektimi për përmirësim dhe zhvillim personal.

Video inçizimi shpesh përdoret për të mbledhur të dhëna lidhur me zhvillimin e veprimtarive në institucion të edukimit në fëmijëri të hershme. Të shikuarit e vetvetes në video inçizim mund t'ju ofrojë një mënyrë unike të "*shikimit të vetvetes në pasqyrë*" derisa udhëheqni një aktivitet apo rutinë tjetër ditore. Nëpërmjet shikimit të video inçizimit dhe diskutimit me kolegët, studentët mund të zbulojnë mënyrat në të cilat ata ndërveprojnë fëmijët. Kujdes me aspektin etik të trajtimit të incizimeve të fëmijëve. Fillimisht duhet të merrni leje nga prindërit për këtë duke treguar atyre se qëllimi i incizimit është vetëm për arsye të vetë-vlerësimit dhe se incizimet nuk do të shfaqen askund dhe do të shkatërrohen pas reflektimit.

Vlerësimi kolegu-kolegut

Studentët mund të përdorin edhe vlerësimin midis kolegëve. Ata mund të kërkojnë nga një kolegë praktikantë në dhomën fqinje që të vëzhgojnë njeri-tjetrin dhe të mësojnë nga perspektiva e një bashkëmoshatare. Kjo është një përvojë e mirë e cila mund të bëhet kulturë e zhvillimit profesional të vazhdueshëm edhe pas përfundimit të studimeve në punën e përhershme.

Informata kthyes nga një kolegë ndikon shumë në përmirësimin e praktikave por edhe vëzhgimi i një kolegu mund të jetë përvojë e mirë, ku mëson nga kolegu praktika të cilat nuk i ke zbatuar më parë.

Shënimet dhe reflektimet

Vëzhguesi duhet t'ia japë studentit një kopje të informatave të mbledhura dhe një përmbledhje me shkrim të bisedës gjatë vëzhgimit të bërë. Përmbledhja duhet të jetë e shkurtër, por duhet të përfshijë përparësitë e identifikuar dhe qëllimet e përcaktuara për zhvillim dhe përmirësim. Studentin edukator duhet inkurajuar që t'i shënojë në ditarin e tij/saj përparësitë të cilat i ka identifikuar vërtetuesi. Studenti edukator po ashtu duhet të shënojë se si do të punojë drejt qëllimeve që i ka përcaktuar për të përmirësuar cilësinë e punës së tij/saj me fëmijë. Shënimet e bëra pas vërtetimit mund të përdoren si referencë për dokumentimin e zhvillimit dhe të ngritjes së studentit si edukator të ardhshëm.

Studentët edukator po ashtu duhet t'i shënojnë reflektimet e tyre në ditar. Shkrimet e tyre në ditar duhet të përfshijnë të menduarit për aktivitetet e të nxënësve dhe lojën përgjatë rutinave ditore apo aktivitetin e tyre, e jo të jenë vetëm shënime faktike. Shkrimet e tyre në ditar duhet të tregojnë se si e lidhin ata teorinë e mësuar me ndërveprimet e tyre me fëmijë. Ata duhet të theksojnë qartë se si do të vepronin ndryshe herën tjetër, për të qenë më efektivë ose për të përmirësuar në ndonjë mënyrë punën e tyre.

Përgjegjësia për mbikëqyrjen e studentëve mësimdhënës ndahet nga mbikëqyrësit e fakultetit dhe të mësimdhënësve mentorë. Qëllimi primar i mbikëqyrjes është që t'u ofrojë studentëve mësimdhënës udhëzime dhe drejtim që atyre i duhet për të bërë progres të vazhdueshëm në zhvillimin e tyre si mësimdhënës të aftë.

Kërkohet që studentët praktikantë të dokumentojnë punën e tyre përmes:

a) Portofolion e studentit.

Një portofolio për planet e aktiviteteve dhe çdo material që përdoret për t'i mbajtur ato. Studentët këtu mund të përfshijnë edhe kopjet e punimeve të fëmijëve (si p.sh. tregime të shkruara) të cilat kanë rezultuar nga puna e tyre.

b) Ditarin e studentit.

Një ditar të lidhur të të shkruarit reflektiv duke treguar të menduarit e studentit lidhur me atë që ka mësuar, dhe synimet e tij/saj për të nxënit e ardhshëm. Kjo do të përfshijë diktatimin e të nxënit nga përvojat dhe vëtvlerësimi, dhe temat në të cilat studenti ka punuar për t'u përmirësuar, si dhe përshkrimin e përmirësimeve të arritura.

c) Ditarin e mbikëqyrësit.

Secili student do të ofrojë një ditar të lidhur në të cilin edukatori/ja mentor dhe mbikëqyrësit nga Fakulteti shkruajnë të dhënat e vërtimit dhe shënimet.

Instrumentet për vlerësimin e studentëve sipas viteve

Gjatë vlerësimit të praktikës pedagogjike, përdoren tre instrumente vlerësuese kyçe. Edukatorët mentore dhe mësimehdhënësit mbikëqyrës ofrojnë vlerësimin e tyre të përparimit të studentit. Një aspekt i rëndësishëm i këtij procesi është vëtvlerësimi i studentit, i cili siguron një perspektivë të brendshme mbi përparimin dhe sfidat që mund të përballen gjatë praktikës së tyre pedagogjike. Këto tre instrumente vlerësuese përbëjnë një pjesë të rëndësishme të vlerësimit të performancës së studentit në zhvillimin e tyre profesional në fushën e arsimit.

Vlerësimi nga ana e edukatores mentorë:

- Përfshin vlerësimin e veprimeve, aftësive, shkathtësive dhe vlerave pedagogjike të studentit në fushën e mësimehdhënies.
- Siguron përkrahje, udhëzim dhe vlerësim të qëndrueshëm për zhvillimin e kompetencave pedagogjike të studentit.
- Identifikon pikat e forta dhe pikat për përmirësim të studentit në lidhje me praktikën pedagogjike.

Vlerësimi nga mësuesi mbikëqyrës:

- Konsiston në vlerësimin e përparimit të studentit dhe zhvillimin e aftësive, shkathtësive dhe vlerave pedagogjike të studentit në fushën e mësimit.
- Ofron komente dhe këshilla objektive për të përmirësuar cilësinë e mësimit të studentit.

Vetëvlerësimi nga ana e studentit:

- Lejon studentin të reflektojë mbi përvojën e tij/të saj në praktikën pedagogjike dhe të identifikojë pikat e forta dhe sfidat.
- Inkurajon analizën e veprimeve dhe rezultateve të mësimit për të përmirësuar performancën dhe për të zhvilluar kompetencat e nevojshme.
- Ndhmon në përgatitjen e një plani të veprimit për të avancuar në zhvillimin personal dhe profesional në fushën e arsimit.

REFLEKTIMI

Reflektimi është një pjesë e rëndësishme e të mësuarit përmes përvojës. Duke reflektuar mbi përvojat tona, ne maksimizojmë potencialin e çdo mësimi apo eksperience të re. Ai është një **proces i të menduarit aktiv** i shoqëruar shpesh herë me të shkruarit dhe të folurit. Reflektimi është një mënyrë për të nxjerrë sa më shumë nga një situatë e nxënies. Nga ndjenjat dhe mendimet që dalin nga ky reflektim mund të gjenerohen përgjithësime, koncepte dhe ide të reja.

Hatton & Smith (1995) definojnë reflektimin si “*të menduar që ka qëllim veprimin me një vështrim për përmirësim e tij*”. Ata identifikuan disa lloje të reflektimit, ku përfshijnë *të shkruarit përshkrues (deskriptiv), reflektimin përshkrues, reflektimin dialogjik (bashkëbisedor) dhe reflektimin* (Hatton & Smith, 1995).

Në vijim janë dhënë shpjegimet për secilin nga këto lloje të reflektimit.

Të shkruarit përshkrues thjesht përshkruan. Nuk është të shkruar reflektiv. Përfshinë përshkrimin e ngjarjes(ve) që ka ndodhur apo përshkruan një vend apo ambient, mirëpo në këtë të shkruar nuk ka përpjekje për të dhënë arsye apo arsyetime për atë se pse kanë ndodhur gjërat ashtu siç paraqiten.

Reflektimi përshkrues. Përfshin jo vetëm përshkrimin e ngjarjeve, por edhe përpjekje për të dhënë arsye dhe/ose arsyetime për ngjarjet apo veprimet e vrojtuesit. Këtu respektohen pikëpamjet dhe mendimet, por shkrimi është në formë të raportit apo përshkrimit.

Reflektimi dialogjik. Demonstron një ‘hap mbrapa’ nga ngjarjet/veprimet drejt të menduarit për vetveten apo të biseduarit me vetveten lidhur me përvojat apo ngjarjet/veprimet. Me fjalë tjera, ai që shruan reflektim dialogjik po i tregon mendimet e tij/saj lidhur me temën dhe po bën përpjekje

që të shpjegojë pse kanë ndodhur ngjarjet apo situatat e përshkruara. Reflektimi i këtillë është analitik dhe mund të përfshijë disa faktorë dhe pikëpamje gjatë përpjekjes për të dhënë argumente dhe kritika. Këtu mund të respektohen jopërputhshmëritë e faktorëve. Ky reflektim përfshinë gjykim dhe marrje parasysh të alternativave të mundshme gjatë përpjekjeve për të shpjeguar.

Reflektimi kritik. Demonstron një vetëdije se ngjarjet dhe veprimet mund të shpjegohen nga pikëpamje të ndryshme dhe se ato ndikohen nga kontekstet e ndryshme historike e socio-politike. Me fjalë tjera, tregon se personi i cili e ka shkruar këtë reflektim kupton se veprimet ose ngjarjet e përshkruara janë bërë komplekse nga shumë faktorë, disa lokalë dhe aktualë dhe disa historikë dhe më të gjerë.

Si mund ta filloj procesin e reflektimit?

Mënyra më e lehtë për të filluar me reflektimin është t'i bëni vetes disa nga pyetjet e mëposhtme në lidhje me përvojën që dëshironi të reflektoni. Mendoni se si mund t'i regjistroni përgjigjet tuaja, për shembull në një ditar reflektues, në mënyrë që t'i mbani mend ato në të ardhmen.

- Çfarë mësova?
- Për çfarë më duhet të mësoj më shumë?
- Pse u ndjeva ashtu siç u ndjeva?
- Çfarë ishte e lehtë?
- Çfarë shkoi mirë?
- Çfarë ishte e vështirë?
- Çfarë shkoi keq?
- Si mund të përmirësohem në të ardhmen?

- Pyes veten se çfarë do të ndodhte nëse...

Si mund të angazhohen studentët edukatorë në reflektim?

Dy strategjitë më të përdorura për angazhimin e studentëve edukatorë në reflektim janë **diskutimi reflektiv** dhe **shkrimi i ditarëve reflektive**. Të dy këto strategji mund të jenë të efektshme dhe të dyja mund të bëhen pjesë e strategjive tjera, më komplekse siç janë studimi i rastit, projekti i hulumtimit të veprimit apo “mikro” mësimdhënia. Diskutimi dhe shkrimi e ditarëve mund të kombinohet në mënyrë efektive. Ky kombinim është i përshtatshëm kur një grup studentësh i ka vërtetuar ndëryprimet apo demonstrimet e njëjta në një klasë. Pas vërtetimit ata mund të diskutojnë dhe pastaj të fillojnë të shkruajnë individualisht për të sqaruar mendimet e tyre pasi t’i kenë dëgjuar mendimet e të tjerëve. Në situatat që përfshijnë vetëm një student edukator, është më adekuate që studenti së pari të shkruajë dhe pastaj shkrimi i tij të shfrytëzohet si bazë për diskutim në grup. Në situata të kështilla, është praktikë e zakonshme që disa studentë t’i shkëmbejnë shkrimet e tyre gjatë diskutimit, dhe jo që diskutimi i grupit të përqendrohet vetëm në shkrimin e një studenti.

Udhëzime të përgjithshme për diskutim reflektiv

Diskutimi reflektiv është në proces i vazhdueshëm i cili mund të zhvillohet në auditor në mes të bartësit të lëndës dhe studentëve, në mes të mësimdhënësit mbikqyrës dhe studentëve, në mes të edukatorës mentore dhe studentëve, por mund të zhvillohet edhe në mes të vet studentëve. Qëllimi i diskutimit reflektiv është që studentët të përfshihen aktivisht në procesin e reflektimit, të kuptojnë rëndësinë e tij dhe gradualisht të aftësohen për të reflektuar në mënyrë kritike. P.sh. nga bartësi i lëndës së praktikës pedagogjike mund të përdoren video të ndryshme në auditor që studentët të fitojnë një eksperiencë paraprake mbi vëzhgimin, mbajtjen e shënimeve, reflektimin, përpara se të shkojnë në praktikën pedagogjike në institucionet e fëmijërisë së hershme. Apo, studentët mund të incizojnë veten e tyre, ose njëri-tjetrin gjatë mbajtjes së një aktiviteti dhe më

pas të diskutojnë me mësimdhënësin mbikqyrës ose edukatoren mentore për shkathtësitë e arritura dhe hapat e ardhshëm për përmirësim.

Është e rëndësishme që udhëheqësi i diskutimit të respektojë të gjitha kontributet në diskutim. Asnjë kontribut nuk duhet gjykuar si më të rëndësishëm apo më të saktë se kontributet tjera.

- Nëse diskutimi përfshinë shkëmbimin e shkrimeve në ditar, kërkonte që pjesëmarrësi t'i lexojë grupit nga ditari. Pjesa që do të lexohet me zë duhet të zgjedhet me kujdes dhe duhet të përmbajë informata të cilat duhet t'i kuptojnë dëgjuesit, dhe të jetë e gjatë aq sa të tjerët të mos e humbin interesimin.
- Nëse ditarët refleksiv shkëmbehen në grup, përkujtoni pjesëmarrësit që puna duhet të jetë konfidenciale dhe të gjithë duhet të jenë të vetëdijshëm për faktin që disa pjesë të shkrimeve mund të jenë të natyrës personale.
- Udhëhiqni diskutimet me pyetje të hapura, të cilat i bëjnë studentët që t'i analizojnë situatat e paraqitura dhe të mendojnë “me zë” për faktorët të cilët ndikojnë në veprimet dhe reagimet e njerëzve. Pyetjet si këto në vijim mund të ndihmojnë, veçanërisht kur diskutohen ndërveprimet në institucionet e fëmijërisë së hershme:
 - Çfarë mendoni pse ka ndodhur kjo?
 - Si ka mundur të jetë ndryshe po të . . . ?
 - Çfarë mendoni pse ka reaguar fëmija ashtu?
 - Çfarë mendoni se do ta ketë shtyrë fëmijën që të bëjë kështu?
 - Çfarë do të mendonte fëmija për . . . ?
 - Si do ta interpretonin prindërit . . . ?
 - Si do ta interpretonin kolegët . . . ?
 - Nga ajo që dini për zhvillimin e fëmijës, çfarë do të parashikonit . . . ?
 - Si jeni ndjerë kur e keni bërë këtë?
 - Cili ishte reagimi juaj i parë ndaj . . . ?
 - Si krahasohet kjo që ndodhi me . . . ?
- Përmbyllni çdo diskutim refleksiv me fjali, me të cilat i riafirmoni studentët. Ua theksoni atyre se si i shihni ju ata duke i zhvilluar shkathtësitë e tyre për të reflektuar dhe për të mësuar nga përvojat e tyre, dhe u thoni se janë duke u mësuar “*të mendojnë si edukator*”

të ardhshëm”. Në këtë mënyrë, duke dhënë shembuj të të menduarit profesional të tyre, ju do ti shtyni ata që të reflektojnë edhe më tepër.

Udhëzime të përgjithshme për të shkruarit reflektiv

Të shkruarit reflektiv dallohet nga të shkruarit përshkruar për shkak të përfshirjes së “**të menduarit**” gjatë procesit të shkrimit. Do të thotë përfshihet ajo që shkruesi (studenti edukator) mendon lidhur me atë që ai/ajo ka parë, ka dëgjuar ose ka përjetuar. Të shkruarit reflektiv shpesh tingëllon si një bisedë në kokën tuaj, prandaj, shkrimi i ideve, mendimeve përmes shkrimit reflektiv përdoret për të qartësuar të menduarit e atij që shkruan dhe të mësuarit bazuar në eksperiencën e jetuar. Kur shkruani në ditarin tuaj, përpikuni të shkruani sa më qartë atë që mendoni.

- Shkruani **idenë tuaj kryesore** në mënyrë të drejtëpërdrejtë. Kjo mund të jetë një fjali apo një pyetje. I shtoni kësaj ideje përshkrime tjera përderisa vazhdoni të shkruarit, duke treguar më shumë për atë që ju mendoni.
- Jepni **shembuj** për të krijuar një pasqyrë më të plotë të ideve tuaja.
- Kur paraqitni një **argument ose mendim**, shfaqni pozitën tuaj drejtpërdrejt dhe pastaj përkrahni atë me arsye.
- **Organizoni** të shkruarit në atë mënyrë që të jetë sa më i qartë. Edhe pse të shkruarit reflektiv në ditar shpesh bëhet në pjesë të vogla që mund të lidhen ose të mos lidhen me njëra-tjetrën, ndonjëherë do të jetë e rëndësishme që të jenë të strukturuar mirë. Për shembull, nëse jeni duke e ritreguar një incident që ndodhi me fëmijët, përdorni në fillim shprehje të drejtpërdrejta, dhe po ashtu në fund ose fjalët tjera që përshkruajnë sekuencë në mënyrë që të bëhet e mundur për të tjerët të imagjinojnë situatën.
- **Zgjidhni fjalë të përshtatshme** dhe precize për t’u komunikuar mendimet tuaja sa më saktë që është e mundur. Zgjedhja e fjalëve mund të bëjë ndryshime të mëdha në transmetimin e kuptimit.
- Në të shkruarit reflektiv, **përfshini edhe pyetjet** që ju bien në mend gjatë kohës kur shkruani ose gjatë kohës së vrojtimit ose mendimit për një situatë të caktuar.

- Baza për të shkruarit reflektiv janë **idetë tuaja**, por mundet dhe duhet të përfshihen edhe idetë e të tjerëve si nxitje për procesin e reflektimit.
- Tregoni qartë se atë që ju e thoni është **mendimi** juaj. I jepni **arsyet** dhe **faktet** tuaja dhe përse e keni atë mendim të caktuar.
- Shpesh është e përshtatshme që në të shkruarit reflektiv të përfshihen **materiallet referuese** duke përfshirë **citatat** për të ndihmuar zgjerimin e ideve. Një shkrim i mirë reflektiv për fëmijët dhe grupet edukative shpesh përmban **lidhje me teorinë** dhe mund të përfshijë citate nga teoricienët për të forcuar idetë e prezentuara.
- Edhe pse të shkruarit e ditarit mund të mos i respektojë të gjitha rregullat e të shkruarit, ata që shkruajnë duhet ta lekturojnë të shkruarit e tyre për të siguruar se porosia është e qartë dhe në përgjithësi është e mbështetur në rregullat e të shkruarit në lidhje me shenjat e pikësimit, drejtshkrimin dhe ndërtimin e fjalisë.
- Një ditar reflektiv duhet të jetë **në lidhje me gjërat që janë të rëndësishme për përvojat nga praktika pedagogjike për vet studentin** përderisa i zhvillon njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet tuaja si edukator të ardhshëm.
- Çdo herë që shkruani, provoni të shfaqni të menduarit tuaj e jo të tregoni ngjarjet që keni parë. **Disa tema** për të cilat mund të shkruani në ditarin tuaj si shtesë e atyre që u janë caktuar nga mbikëqyrësi janë të radhitura më poshtë, si:
 - Vrojtimi i ndërveprimit ndërmjet fëmijëve,
 - Vrojtimi i fëmijës (zhvillimi fizik, social, emocional, kognitiv, gjuhësor),
 - Vrojtimi i raporteve midis edukatorëve dhe fëmijëve,
 - Vrojtimi i raporteve midis prindërve dhe fëmijës,
 - Vrojtimi i mënyrës përmes së cilës edukatori/ja mentor e paraqet ose e përfundon një aktivitet,
 - Organizimi i mjedisit - si është organizuar dhe pse është organizuar ashtu?
 - Vrojtimi i dallimeve në mes të djemëve dhe vajzave derisa angazhohen në aktivitete,
 - Disa aspekte të filozofisë së mësimdhënies suaj,

- Pyetjet për të cilat do t'i donit përgjigjet lidhur me një temë të caktuar,
- Ndryshimet që ju i keni vërejtur në të menduarit tuaj qysh se keni filluar praktikën pedagogjike,
- Gjërat e mësuara ose pyetjet e ngritura në bisedën me bashkëmoshatarët ose me edukatorët e tjerë,
- Të menduarit për nevojat e fëmijëve në një moshë të caktuar ose në një fazë të caktuar të zhvillimit,
- Të menduarit për disa aspekte të të qenit edukator dhe ballafaqimi i sfidave që paraqet ky profesion,
- Të menduarit për ndryshimet në shkollim nga koha kur ju keni qenë fëmijë deri tash kur jeni bërë mësues.
- Mësimet e vërejtura të zhvillimit të aftësive të mësimit.
- Ndihmesën e të menduarit dhe të shkruarit kreativ të mendimit.
- Shërbimin si një mjet për shënimin e përgjigjeve ndaj të lexuarit, teksteve, punës, filmave, vërejtjeve, intervistave dhe përvojave të tjera të ngjashme.
- Krijimi i një regjistri kronologjik të aktiviteteve.
- Dhënia e kuptimit çështjeve që ndikojnë në jetërat e tyre personale.
- Ndihma për të kuptuar ndërvëprimin në klasë.
- Ata mund të pyesin veten se pse ndodhi një ngjarje ashtu siç ndodhi
- Të ndërmarrin hapa për të gjetur zgjidhje për përmirësimin e praktikës së tyre.

Disa detaje praktike rreth shkrimit në ditarin reflektiv:


- Para se të fillojë praktikën pedagogjike, merrni një ditar me fletë të lidhura që ju do ta përdorni si ditarin tuaj. Mund ta përdorni një ditar që ju mendojnë se do t'ju shërbejë si ditar për disa semestra. E shënoni qartë emrin tuaj. Poashtu ju mund të përdorni ditarin elektronik i cili është vënë në përdorim të studentëve dhe e gjeni në ëeb-faqen e fakultetit.

- Sa herë që shkruani në ditar, shënoni **datën** se kur i keni mbledhur ato të dhëna shkrime, fotografi, komente, punim i fëmijës.
- Gjatësia e shkrimit në ditar do të ndryshojë nga një gjysmë faqeje deri në një gjatësi prej disa faqesh. Nuk ka gjatësi korrekte ose të gabuar. Mjafton që secili shkrim reflektiv të paraqes atë që ishte e rëndësishme për studentin.
- Jini të kujdesshëm gjatë shkrimit të emrave të vërtetë në ditar. Është më mirë t’u referoheni fëmijëve vetëm me emrin e tyre (e jo edhe me mbiemër) dhe të të rriturve t’u referoheni si “Znj. E” për shembull. Ju mund të zgjedhni nëse doni t’i jepni personave pseudonime.
- Ruajtja e etikës profesionale dhe respektimi i kodit të mirësjelljes profesionale janë të rëndësishme edhe në procesin e shkrimit.
- Plotësoni ditarin vazhdimisht. Gjatë praktikës pedagogjike shkruani shpesh në ditarin tuaj në mënyrë që t’ju ndihmojë që të mbani rrjedhën e të nxëniet dhe të pyetjeve tuaja.
- Mund të shkruani derisa jeni në institucion parashkollor apo në klasë parafillore, gjatë asaj kohe kur nuk keni përgjegjësi për organizimin e aktiviteteve ose për mbikëqyrjen e fëmijëve. Mos lejonit që të gjitha gjërat t’i shkruani në fund të ditës.
- Kur të përfundoni të shkruarit në ditarin tuaj, kthehuni prapa dhe lexoni përsëri atë që keni shkruar atë ditë. Përderisa e lexoni, nënvizoni fjalët kyçe që do t’ju ndihmojë të identifikoni temën e shënimit në ditar. Ndonjëherë mund të vendosni që ta shënoni edhe titullin e atij shënimi. Ndonjëherë mund të vendosni që të shtoni një fjali përmbledhëse ose një pyetje pasi ta keni rilexuar dhe rimenduar temën.
- Është e rëndësishme që të definohet se studentët janë ata që mbajnë kontroll për të shkruarit e tyre dhe atë që thonë nuk do të gjykohet si e vërtetë apo gabim. Studentët edukatorë duhet të jenë të sigurtë se nuk ka mënyrë të drejtë apo të gabuar të interpretimit të asaj që vrojtojnë derisa i shikojnë dhe i dëgjojnë fëmijët në institucionet e fëmijërisë së hershme.
- Përvoja gjithashtu ka treguar se është e natyrshme për studentët që janë fillestarë në të shkruarit e ditarit, që shkrimi i tillë të jetë më së shumti përshkrues. Shkrimi i tillë duhet

të pranohet si pikë fillestare. Të mësuarit se si të reflektohet është një proces që zhvillohet dhe studentët edukatorë kanë nevojë për kohë, përvojë, udhëzime dhe inkurajim për të fituar shkathtësi si mendimtarë reflektues që mësojnë nga të menduarit e tyre dhe të të tjerëve.

Procesi i reflektimit sipas modelit teorik të Boud ¹

Paraqitja trekëndore e Boud (1985) është mbase modeli më i thjeshtë i reflektimit. Kuadri ciklik fillon me përvojën, kalon te reflektimi dhe pastaj mbi të mësuarit. Ndërsa përqendrohet në besimin thelbësor se të menduarit reflektues çon në të mësuarit e mëtejshëm.



Eksperienca: Ka të bëjë me përshkrimin e ngjarjes. Çfarë?

Reflektimi: Përzgjedhja e ngjarjes/ngjarjeve. Edhe çfarë?

Të mësuarit: Çfarë është mësuar dhe cili është ndikimi? Tani çfarë?

¹ Adoptuar sipas: Annie Pendrey (2022), *The Little Book of Reflective Practice: A Practical Guide to the Early Years*, Routledge

Procesi i reflektimit sipas modelit teorik të Schön²

Schön (1983) ka dhënë një kontribut të rëndësishëm për të na udhëhequr në kuptimin dhe zbatimin e teorisë në praktikën tonë profesionale. Schön (1983) sugjeron që ne të reflektojmë në veprim dhe kjo pasohet nga reflektimi ynë mbi veprim.

Procesi i **reflektimit-në-veprim** dhe **reflektimit-për-veprim** ju kërkon të vini re se çfarë po ndodh **“në veprim”**, të reflektoni mbi situatën dhe pothuajse të riimagjinoni situatën, **“veprimin”** dhe të adoptoni një perspektivë të re, të ndërtoni mirëkuptim të ri, dhe zbatoheni këtë në situatë. Në të njëjtën kohë, merrni kohë për të marrë parasysh ndjenjat tuaja në lidhje me përvojën dhe çfarë mbështetje mund të keni nevojë për të ecur përpara në mësimin tuaj.

Reflektimi i mëtejshëm mbi veprim është koha që kaloni duke parë situatën dhe potencialisht duke shpenzuar 5 minuta për të kapur mendimet tuaja reflektuese në ditarin tuaj, duke kapur aspektet pozitive dhe potencialisht disa fusha të zhvillimit përpara se të shkruani një përmbledhje reflektuese.

Le të ndalemi dhe të shqyrtojmë se çfarë nënkuptojnë këto terma dhe si zbatohen për praktikën tuaj profesionale dhe praktikën tuaj reflektuese.

Reflektimi NË veprim

Këtu do të reflektoni teksa ndodh diçka, ajo në momentin e ndodhjes. Është këtu që Schön ju kërkon:

- Mendoni se çfarë po ndodh, merrni parasysh situatën.
- Tani reagoni dhe mendoni menjëherë, vendosni si të reagoni dhe çfarë duhet bërë më pas.
- Më pas veproni menjëherë për situatën.

Reflektimi MBI veprimin


Këtu do të reflektoni pas situatës. Është këtu që Schön ju kërkon:

- Rishikoni situatën dhe merrni parasysh çfarë ka nevojë duke ndryshuar.
- Reflektoni dhe vendosni se çfarë do të bëni herën tjetër në këtë situatë dhe veproni sipas saj.

² Adoptuar sipas: Annie Pendrey (2022), *The Little Book of Reflective Practice: A Practical Guide to the Early Years*, Routledge

Procesi i reflektimit sipas modelit teorik të Gibbs

Cikli reflektues i Gibbs (1998) ka për qëllim të ndihmojë në të menduarit në mënyrë më sistematike për elementët ose fazat e një përvojë ose aktiviteti që keni ndërmarrë ndërsa kaloni nëpër 6 fazat dhe shumë praktikues e shohin të dobishme t'u përgjigjen pyetjeve të ciklit ndërsa ata ndërtojnë mendimet dhe shkrimet e tyre reflektuese dhe fillojnë të familjarizohen me këtë model teorik. Këto gjashtë faza kanë të bëjnë me:



Faza 1 Përshkrimi – Çfarë ndodhi?

Përpara se të filloni fazën e parë, është e dobishme të ndaloni dhe të mblidhni mendimet tuaja, të shikoni çdo shënim nga ditari juaj ose shënimet reflektuese, të mblidhni ndonjë shënim ose reagim nga kolegët, kolegët ose mentori juaj. Tani jeni gati t'i përgjigjeni pyetjes, çfarë ndodhi?

Jini të vetëdijshëm kur filloni t'i përgjigjeni kësaj pyetjeje, duhet të bëni më shumë sesa të jepni një shpjegim të ngjarjeve, ju kërkohet të përshkruani atë që ndodhi brenda aktivitetit/vëzhgimit dhe kështu duhet të shtoni thellësi. Për shembull, çfarë mësimi ka ndodhur, cilat fusha të zhvillimit janë mbuluar janë vetëm disa shembuj të përshkrimit të asaj që ndodhi në vëzhgimin/aktivitetin që mund të keni ndërmarrë. Ju gjithashtu mund të filloni të mendoni për shtimin e më shumë detajeve, si p.sh. çfarë ndodhi në atë kohë gjatë dhe pas aktivitetit/vëzhgimit, kështu që këtu po i ndani përshkrimet dhe po i jepni llogarisë tuaj reflektuese shumë më tepër thellësi.

Faza 2 – Ndjenjat – Çfarë po mendoni dhe si po ndjeheni?

Kjo fazë do t'ju kërkojë të reflektoni mbi ndjenjat tuaja dhe këtu është e rëndësishme që ju të jeni të sinqertë, për shembull nëse situata ishte sfiduese, atëherë thuani kështu. Është natyra njerëzore që të gjithë ne si profesionistë të shfaqim ose ndjejmë një sërë emocionesh kur jemi duke u vëzhguar ose nëse planifikoni një aktivitet dhe ndoshta nuk shkon sipas planit. Ju mund të ndiheni të dëshpëruar, por pastaj mund të filloni të mendoni se si jeni përshtatur me situatën, në të njëjtën mënyrë mund të shikoni prapa në mendimet dhe ndjenjat tuaja dhe të identifikoni se si duhet ta trajtoni këtë herën tjetër kur do të gjendeni në këtë situatë. Për më tepër, ju lutemi kujtoni dhe reflektoni mbi të gjitha mendimet dhe ndjenjat pozitive që përjetoni, pasi njerëzit shpesh nuk i festojnë sa duhet gjërat pozitive nëpër të cilat ata kalojnë.

Faza 3 – Vlerësimi – Çfarë ishte pozitive dhe/ose negative në lidhje me situatën?

